



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”

Shënim: Realizimi i këtij auditimi performance është kryer me mbështetjen e Institucionit Suprem të Auditimit të Norvegjisë, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që KLSH ka nënshkruar me këtë institucion.

Tiranë, 2025

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA	4
2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	5
2.1 Konteksti i problemit social.....	5
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	6
3. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM	7
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	9
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	10
3.4 Pesha në buxhet.....	12
3.5 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	12
4. DETAJET E AUDITIMIT	13
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	13
4.2 Objektivi i auditimit.....	14
4.3 Pyetjet e auditimit.....	15
4.4 Fushëveprimi i auditimit.....	16
5. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	16
5.1 A janë strukturat e ngritura të përshtatshme për dhënien e shërbimit psiko-social?.....	16
5.2 A e përmbush shërbimi psiko-social rolin e tij për identifikimin dhe adresimin e problematikave në shkolla?.....	30
5.3 A janë politikat dhe veprimtaritë e institucioneve në mbështetje të mirëfunksionimit të shërbimit psiko-social?.....	41
6. Observacione të subjekteve të audituara	52

Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Emërtimi i plotë
RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
INSTAT	Instituti i Statistikave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSHRF	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
UP	Urdhri i psikologut
UPS	Urdhri i punonjësit social
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar
IA	Institucioni arsimor
NJSHPS	Njësia e shërbimit psiko-social në shkollë
SHPS	Shërbimi psiko-social
NJMF	Njësia e mbrojtjes së fëmijëve
AK	Aftësia e kufizuar
PEI	Plani edukativ individual
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
SWOT	Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet

1. PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë, “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”, kishte si objektiv kryesor, vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre. Në këtë mënyrë ne synuam të identifikojmë mangësitë, shkallën e zbatimit të standardeve dhe propozimin e masave korrigjuese për të përmirësuar zbatimin e politikave dhe procedurave, në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi nga institucionet publike të arsimit parauniversitar në vend. Auditimi u krye mbi veprimtarinë e institucioneve për periudhën 01.01.2020 deri më 30.04.2024.

Për shkak të kompleksitetit të tij, auditimi ka një qasje të kombinuar, duke parë nga perspektiva e funksionalitetit që institucionet kanë në lidhje me hartimin, zbatimin e politikave por dhe implementimin e efektshëm të tyre. Rëndësi i`u kushtua bashkëpunimit midis aktorëve me fokus shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve si trashëgimi e brezave të ardhshëm.

Gjatë këtij auditimi u fokusua në disa institucione qendrore si, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, si dhe disa institucione të varësisë së saj. Këtu përmendim, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Lezhë, Korçë, Fier, disa Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar si dhe Institucione Arsimore të vizituara. Numri i lartë i institucioneve të përzgjedhur u bë për të pasur një panoramë më të plotë të situatës.

Për temën objekt auditimi u zhvillua takim me staf pedagogjik të Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, lidhur me qasjen pedagogjike në formimin e psikologëve dhe punonjësve social të ardhshëm. Po në këtë kuadër, u zhvillua takim edhe me staf të Departamentit të Promovimit dhe Zhvillimit të Shëndetit në Universitetin e Bergenit Norvegji, mbi studimet të zhvilluara tek fëmijët dhe adoleshentët, trendet, përvojat dhe rezultatet nga programet/masat që synojnë shëndetin mendor dhe mjedisin shkollor.

Auditimi u orientua në disa kolona bazë si, mbulimi me shërbim psiko-social në territor, infrastruktura dhe kapacitetet e nevojshme në mbështetje të tij, cilësia e shërbimit sa i përket identifikimit të problematikave dhe përgjigjes ndaj rasteve. Gjithashtu, politikat e ndërmarra, ndërveprimet mes institucioneve dhe kuadri ligjor e rregullator në fuqi për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social ishte gjithashtu një nga kolonat e tij.

Nga auditimi rezultoi se, sistemi i ngritur nuk garanton shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkolla, për të mësuar në një mjedis më të sigurt dhe mbështetës. Shërbimi psiko-social aktualisht paraqet një qasje reaguese në vend të ndërhyrjes parandaluese. Ngritja dhe funksionimi i tij, nuk garanton mbulim efektiv me shërbim në të gjitha shkollat e vendit. Nga ana tjetër, përfshirja e njëllojtë dhe e pa standardizuar e figurës së psikologut dhe punonjësit social, si dhe kufizimet e vendosura për rekrutimin e psikologut, ka krijuar vështirësi në rekrutime dhe boshllëqe në mbulim. Mbikëqyrja mbi cilësinë e shërbimit dhe plotësimin të infrastrukturës së nevojshme ka munguar, duke krijuar hapësirë për zhvillimin e veprimtarisë pa plotësuar standardet e përcaktuara. Koordinim i dobët vihet re mes institucioneve të linjës, ku evidencat e prodhuara mbi shërbimin nuk arrijnë të vlerësohen cilësisht dhe të shkëmbehen në mënyrë të rrjedhshme, për tu përdorur në hartimin e politikave të përshtatshme apo rishikimin e atyre ekzistuese. Strategjitë aktuale të hartuara lidhur me shëndetin mendor, arsimin parauniversitar dhe të drejtat e fëmijëve, trajtojnë pjesërisht dhe në mënyrë sipërfaqësore këtë shërbim. Masat e parashikuara në këto strategji shpesh herë janë të mbivendosura dhe të paqarta, mbi mënyrën si duhet të zbatohen nga institucionet, në përputhje me fushën e përgjegjësisë së tyre shtetërore. Kuadri rregullator për shërbimin psiko-social është i pa harmonizuar, në disa raste kontradiktor me legjislacion aktual, si dhe vendos barrierë të panevojshme për profesionistët.

Në përfundim janë gjeneruar gjetje të cilat theksojnë mangësi të subjekteve nën auditim, për të cilat janë dhënë rekomandime specifike, shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

2.1 Konteksti i Problemit Social

Shoqëria shqiptare përballlet me një sërë sfidash sociale dhe ekonomike që ndikojnë ndjeshëm në shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve. Disa nga sfidat kryesore përfshijnë varfërinë, papunësinë dhe problemet e përhershme ekonomike për shumë familje, të cilat ndikojnë ndjeshëm tek fëmijët, duke shkaktuar ankth, stres dhe vështirësi në përqendrim dhe motivim në mësim. Për më tepër, edhe bullizmi, si në mjediset e shkollës ashtu edhe në mediat sociale, është një fenomen që ndikon negativisht në mirëqenien psiko-sociale të nxënësve. Këto fenomene shpesh sjellin pasoja të rënda psikologjike për të rinjtë, duke i lënë ata të ndihen të izoluar dhe të pasigurt. Një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve përjetojnë pasiguri dhe konflikte brenda familjeve të tyre, dhunë në familje apo keqtrajtim, qoftë psikologjik apo fizik. Sipas një raporti të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i publikuar nga UNICEF¹ mbi monitorimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, nga një anketë e zhvilluar për këtë qëllim është evidentuar se fëmijët gjykojnë që shkollat duhet të bëjnë më shumë për të bërë të disponueshëm informacionin fenomenet e dhunës dhe bullizmit në shkolla, duke zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese më të shpeshta nga psikologu dhe punonjësi social. Sipas tyre këto aktivitete duhet të japin informacion për internetin e sigurt dhe të sensibilizojnë për problematikat e dhunës që mund të përjetojnë fëmijët. Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se ka nevojë për nxitje të bisedave informuese midis shkollës dhe prindërve për çështje të përdorimit të rrjeteve sociale, për kontrollin prindëror, si dhe çështje që të dyja palët i konsiderojnë si të rëndësishme.

Për këto arsye, shërbimi psiko-social në sistemin parauniversitar është një mekanizëm kyç për t'u përballur me këto sfida dhe për të siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe mbështetës për nxënësit. Ofrimi i mbështetjes emocionale nga psikologët dhe punonjësit socialë të trajnuar është një ndihmë e madhe që vjen në momente delikate për fëmijët e moshave të ndryshme. Shërbimi psiko-social ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e problemeve emocionale, duke përmirësuar mirëqenien psikologjike dhe rritur përqendrimin dhe performancën akademike të nxënësve. Nëpërmjet monitorimit dhe ndërhyrjes në faza të hershme, psikologët dhe punonjësit socialë në shkolla mund të parandalojnë sjellje problematike si bullizmi, abuzimi me substancat dhe sjelljet devijuese. Ky shërbim mbështet edukimin për sjellje të shëndetshme dhe tolerante, që janë thelbësore për zhvillimin e një klime pozitive në shkolla dhe në shoqëri në përgjithësi. Në një moshë kur formohen personalitetet dhe ndërtohen bazat për të ardhmen, mbështetja psiko-sociale ndihmon në identifikimin dhe adresimin e vështirësive emocionale, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe përfshirës për të gjithë nxënësit. Ky shërbim mundëson që nxënësit të përqendrohen më mirë në mësim, të zhvillojnë aftësi të mira përballuese dhe të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët.

Për më tepër, ndihma profesionale e vazhdueshme mbështet mësuesit dhe prindërit në trajtimin e çështjeve të ndryshme që mund të ndikojnë në suksesin akademik dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve, duke kontribuar kështu në një arsim më cilësor dhe një shoqëri më të shëndetshme.

Për shkak të rëndësisë që ka ky shërbim në mirëqenien e fëmijëve, prindërve, por edhe stafit akademik të shkollave, nevojitet që ai të jetë efektiv dhe i shtrirë në të gjithë territorin e vendit, sepse kështu siguron që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, të kenë qasje të barabartë në mbështetje emocionale dhe sociale, që është thelbësore për zhvillimin e tyre të shëndetshëm dhe të balancuar. Pa këtë mbulim të plotë, fëmijët në zona rurale apo të largëta mund të mbeten pa ndihmën e nevojshme, duke rritur kështu pabarazitë

¹ Raporti i Monitorimit Afatmesëm të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve <https://www.unicef.org/albania/media/6356/file/Raporti%20i%20Monitorimit%20Afatmes%C3%ABm%20t%C3%AB%20Agjend%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20Drejtat%20e%20F%C3%ABmij%C3%ABve.pdf>

në mundësitë e tyre për zhvillim dhe arsimim. Gjithashtu, një shërbim psiko - social i pranishëm në të gjithë vendin kontribuon në identifikimin e hershëm dhe trajtimin e problemeve psiko-sociale, që mund të ndikojnë negativisht në performancën akademike dhe mirëqenien e përgjithshme të nxënësve. Kjo parandalon përkeqësimin e problemeve dhe ndihmon në krijimin e një mjedisi shkollor më të sigurt dhe më përfshirës. Duke qenë efektiv dhe gjithëpërfshirës, ky shërbim mbështet prindërit dhe mësuesit, duke u ofruar atyre burimet dhe udhëzimet e nevojshme për të ndihmuar fëmijët të përballen me sfidat emocionale dhe sociale. Kjo nxit një qasje të integruar dhe të bashkërenduar në trajtimin e mirëqenies së fëmijëve, duke e bërë sistemin arsimor më të fortë dhe më efektiv. Megjithatë, pavarësisht faktit se ky lloj shërbimi në vendin tonë po sigurohet në institucionet arsimore parauniversitare, ende ai nuk është konsoliduar në tërësinë e tij.

Referuar një raporti të hartuar në vitin 2021, mbi Sfidat dhe Nevojat e Punonjësit të Njësisë Psiko-Sociale në Shkollat², shërbimi psiko-social në Shqipëri përballlet me disa problematika të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e tij. Një nga sfidat kryesore është mungesa e burimeve dhe infrastruktura e pamjaftueshme, që shpesh çon në pamundësinë për të ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për të gjithë nxënësit. Në shumë shkolla mungojnë profesionistët e trajnuar si psikologët dhe punonjësit socialë, duke krijuar boshllëqe në ofrimin e shërbimeve të nevojshme. Për më tepër, ekziston një mungesë e ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi rëndësinë e shëndetit mendor, që shpesh çon në stigmatizimin e nxënësve që kërkojnë ndihmë psiko - sociale. Financimet e pamjaftueshme dhe mbështetja e kufizuar nga autoritetet përkatëse gjithashtu kontribuojnë në vështirësitë në përmirësimin e këtij shërbimi. Këto problematika krijojnë pengesa të konsiderueshme në përmbushjen e nevojave psiko - sociale të nxënësve, duke ndikuar negativisht në mirëqenien dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performancë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, u ndërмор auditimi me temë, “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”, duke e konsideruar një çështje të rëndësishme dhe me impakt social. Nëpërmjet këtij auditimi synojmë të paraqesim situatën lidhur me shërbimin psiko - social në vend, si dhe të analizojmë sistemin e ngritur, veprimtaritë e ndërmarra nga institucionet e përzgjedhura për auditim, në funksion të mirë funksionimit të

² Raporti i Terres des Hommes, Sfidat dhe Nevojat e Punonjësit të Njësisë Psiko - Sociale në Shkollat: https://tdh-albania.org/sites/default/files/2022-07/Raporti%20vleresimit%20te%20nevojave%20Draft%20Final%2009.08.2021_30.08.2021_Clean_MGR.pdf

procese dhe veprimtarive të ndërmarra. Në përfundim janë dhënë rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

3. SUBJEKTET NËN AUDITIM

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet e përfshira në këtë auditim janë:

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit;
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
3. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
4. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
5. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe njësi në varësi të saj.

-Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e arsimit parauniversitar në Shqipëri që synojnë sigurimin e një sistemi arsimit cilësor, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, të komunitetit dhe shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme. Gjithashtu MAS, harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese. Prej vitit 2017 deri në vitin 2021 kjo ministri ka patur nën përgjegjësi dhe ka mbuluar edhe fushën “Për Rininë”, e cila në vitin 2021 i është shkëputur³ asaj duke u riorganizuar në formën e një ministrie të veçantë pa portofol.

-Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është institucioni përgjegjës për, hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive zhvillimore në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ajo është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe koordinimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor. Gjithashtu, garanton të drejtat kushtetuese për mbrojtje dhe përfshirje sociale, kujdes social dhe mundësi të barabarta. MSHMS i mbulon këto fusha përgjegjësie prej vitit 2017⁴.

-Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF) është krijuar në vitin 2021⁵ është përgjegjës për, hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirëritjen dhe mirë edukimin e tyre. Ministri i Shtetit, ndër të tjera, bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikase, si dhe me autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

-Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) është institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, me seli në Tiranë. ASCAP është përgjegjëse për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, zhvillimin profesional dhe kualifikimin e punonjësve arsimorë, monitorimin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe programet e tyre mësimore si dhe të sigurojë zhvillimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, publik dhe privat.

³ VKM nr. 523, datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”;

⁴ VKM nr. 508, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”;

⁵ VKM nr. 524 datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”.

-Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), është një institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, me seli në Tiranë. AKAP është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruesve të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë përbërëse e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e synimit të përgjithshëm për shërbim cilësor arsimor. AKAP ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe është përgjegjëse për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.


-Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal. Ato menaxhojnë, mbikëqyrin, vlerësojnë dhe kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sigurojnë zbatimin e kurrikulës, metodologjive dhe standardeve, kërkojnë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore, grumbullojnë dhe përpunojnë të dhënat statistikore nga institucionet arsimore nën juridiksionin e tyre, etj.

-Njësitë e Shërbimit Psiko - Social (NJPSSH), veprojnë në nivel Drejtorie Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe përbëhen nga psikologë, punonjës socialë, drejtuesi i NJSP-së dhe një mbikëqyrës.

Drejtuesi i NJSP-së kryen detyrat e përcaktuara në Urdhrin e Ministrit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar, si dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore, neni 30, pika 4. NJSP-të kanë si detyrim hartimin e planit vjetor, organizimin e mbledhjeve mujore dhe koordinimin me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve për të trajtuar çështjet e abuzimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. Ata gjithashtu komunikojnë me institucionet arsimore (IA) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) në lidhje me fëmijët në rrezik, mbikëqyrin psikologët dhe punonjësit socialë të njësisë dhe hartojnë raporte gjashtëmujore të aktivitetit.

-Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), mbikëqyrin veprimtarinë dhe funksionimin e përditshëm të institucioneve arsimore, përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsinë e procesit mësimor. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar, në varësi të numrit të nxënësve, parashikojnë numrin e nevojshëm të psikologëve/punonjësve socialë duke përcaktuar edhe institucionet arsimore për çdo vend të lirë në momentin e shpalljes së konkursit dhe i dërgojnë zyrtarisht në DRAP. Njësitë arsimore vendore ofrojnë shërbime psiko-sociale për studentët dhe punonjësit e institucioneve arsimore. Ky shërbim ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve apo punonjësve socialë për trajtimin e problemeve të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit të shkollës.

Figura. 1 Skema e aktorëve kryesorë në sektorin e shërbimeve psiko-sociale



3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

3.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Dispozitat e ligjit nr. 7850 “Kodi Civil” date 29.07.1994, i ndryshuar, që rregullon aspekte të personave të mitur;
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji nr. 40/2016: “Për Urdhrin e Psikologut në Shqipëri”;
- Ligji nr. 163/2014: “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Shqipëri”;
- Të tjera.

3.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- VKM nr. 210 datë 06.04.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030”;
- VKM nr. 621 datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e saj”;
- VKM nr. 659 datë 03.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026”;
- VKM nr. 1139, datë 24.12.2020: Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë (2021-2026);
- VKM nr. 98 datë 27.2.2019: “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”;
- VKM nr. 99 datë 27.2.2019: “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP)”, i ndryshuar;

- Urdhri i Ministrit nr. 313 datë 20.10.2020: “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Psiko-social” i ndryshuar;
- Manuali i punës për punonjësit psiko-socialë (2020);
- Urdhri i Përbashkët i Ministrive (2018): Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në Republikën e Shqipërisë;
- Rregullore të brendshme të subjekteve nën auditim;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore që do dalin gjatë auditimit, të cilat lidhen me fushën që auditohet;
- Të tjera.

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Politikat për shërbimin psiko-social në shkolla në Shqipëri synojnë të ofrojnë një sistem të integruar mbështetjeje për nxënësit përmes qasjeve që promovojnë shëndetin mendor dhe mirëqenien e tyre emocionale dhe sociale. Ky sistem bazohet në disa politika dhe plane kombëtare ku përfshihet:

-Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 – Kjo strategji përfshin objektiva specifike për përmirësimin e programeve socio-shëndetësore, me fokus në ndërhyrjet e hershme dhe integrimin e shërbimeve për nxënësit që kanë nevoja psiko-sociale. Kjo strategji inkurajon kujdesin psiko-social të ofrohet në mënyrë të barabartë dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha shkollat e vendit.

-Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026 – Ky plan synon të zhvillojë programe dhe struktura që mbështesin shëndetin mendor të nxënësve në shkolla, përfshirë krijimin e ekipeve multidisiplinare dhe përfshirjen e prindërve e komunitetit. Ky plan vë theksin tek parandalimi i problemeve të shëndetit mendor dhe promovimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për nxënësit.

-Udhëzimi nr. 39, datë 12.08.2015, është një dokument specifik që përcakton rolet, përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të ndjekin psikologët dhe punonjësit socialë në shkollat e Shqipërisë. Ai përmban rregulla për ofrimin e këshillimit, për ndërhyrjen në raste të veçanta, si dhe për mbështetjen që duhet ofruar për grupet e ndryshme të nxënësve. Në sistemin parauniversitar në Shqipëri, vendosja dhe funksionimi i psikologëve dhe punonjësve socialë bazohen në disa kriteret të përcaktuara nga politika arsimore dhe strategjitë kombëtare për mbështetje psiko-sociale. Psikologët dhe punonjësit socialë duhet të kenë kualifikime të përshtatshme në fushat e psikologjisë dhe punës sociale, duke përfshirë diplomën e arsimit të lartë dhe licencat përkatëse. Vendosja e tyre në shkolla shpesh bazohet në numrin e nxënësve dhe në nevojat specifike të shkollës. Shkollat me një numër të madh nxënësish ose me probleme të shprehura të sjelljes dhe të mirëqenies psiko-sociale përfitojnë prioritet. Zakonisht, një psikolog ose punonjës social mbulon disa shkolla, veçanërisht në zona rurale ku numri i nxënësve është më i vogël dhe shkollat janë të larg nga njëra-tjetra. Në qytete dhe zona me densitet të lartë të popullsisë, çdo shkollë mund të ketë një psikolog dhe një punonjës social.


Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe strukturat përkatëse të Ministrisë së Arsimit janë përgjegjëse për monitorimin e punës së psikologëve dhe punonjësve socialë. Ata vlerësojnë performancën e tyre përmes raportimeve të rregullta dhe vizitave inspektuese. Profesionistët psikologë dhe punonjës social duhet të raportojnë periodikisht mbi punën e tyre, aktivitetet dhe ndërhyrjet që kryejnë në shkolla. Këto raporte ndihmojnë në matjen e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe në identifikimin e nevojave për përmirësime të mundshme. Këto kriteret, bashkë me shpërndarjen dhe monitorimin efektiv, synojnë të garantojnë mbështetje të qëndrueshme dhe të barabartë për të gjithë nxënësit në Shqipëri.

Politikat synojnë të sigurojnë një mbështetje të vazhdueshme për nxënësit, duke adresuar problemet e shëndetit mendor që mund të ndikojnë në performancën dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Synohet parandalimi i situatave të krizës dhe ofrimi i mbështetjes psiko-sociale

që ndihmon në zhvillimin e një mjedisi pozitiv dhe të qëndrueshëm në shkollë. Me prezencën e psikologëve dhe punonjësve socialë, nxënësit ndihen më të sigurt për të kërkuar ndihmë kur përballen me sfida emocionale apo probleme të tjera psiko-sociale. Kjo kontribuon në reduktimin e ankthit, stresit dhe problematikave të tjera që ndikojnë në shëndetin mendor të tyre.

Politikat për shërbimin psiko-social në shkolla në Shqipëri synojnë të ofrojnë një sistem të integruar mbështetjeje për nxënësit përmes qasjeve që promovojnë shëndetin mendor dhe mirëqenien e tyre emocionale dhe sociale. Ky sistem bazohet në disa politika dhe plane kombëtare që përfshijnë:

Figura 2. Sistemi i ngritur për mbështetjen psiko-sociale në shkolla.



Politikat synojnë të sigurojnë një mbështetje të vazhdueshme për nxënësit, duke adresuar problemet e shëndetit mendor që mund të ndikojnë në performancën dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Synohet parandalimi i situatave të krizës dhe ofrimi i mbështetjes psiko-sociale që ndihmon në zhvillimin e një mjedisi pozitiv dhe të qëndrueshëm në shkollë. Me prezencën e psikologëve dhe punonjësve socialë, nxënësit ndihen më të sigurt për të kërkuar ndihmë kur përballen me sfida emocionale apo probleme të tjera psiko-sociale. Kjo kontribuon në reduktimin e ankthit, stresit dhe problematikave të tjera që ndikojnë në shëndetin mendor të tyre.

3.4 Pesha në buxhet

Më poshtë paraqiten disa nga treguesit buxhetorë sipas programeve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar sipas viteve. MAS është institucioni kryesor i cili menaxhon dhe çel fondet për institucionet qendrore dhe institucionet

e varësisë. Nga ministrive përgjegjëse nuk u arrit të bëhej një ndarje e qartë e fondeve specifike të akorduara prej tyre për shërbimin psiko-social në arsimin parauniversitar. Ndërkohë AKAP dhe ASCAP kanë paraqitur disa tregues mbi shpenzimet e kryera prej tyre.

Tabela. 1: Buxhetet e MAS sipas viteve.

/000 lekë

Kodi Buxhetor	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shpenzimeve Buxhetore Viti 2023	Totali i Shpenzimeve Buxhetore Viti 2022	Totali i Shpenzimeve Buxhetore Viti 2021	Totali i Shpenzimeve Buxhetore Viti 2020
011	Ministria e Arsimit dhe Sportit				
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	795 879	821 320	722 000	735 000
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	25 290 434	24 857 517	22 792 076	23 320 720
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	8 030 687	7 813 600	7 199 000	7 364 043
	Shuma	34 117 000	33 492 437	30 713 076	31 419 763

Burimi. Faqja zyrtare e MAS përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela. 2 Buxhetet e AKAP sipas viteve.

/000 lekë

Kodi i Programit	Art.	Emertimi	Buxheti fakt Viti 2023	Buxheti fakt Viti 2022	Buxheti fakt Viti 2021	Buxheti fakt Viti 2020
01110	600	Paga	25 376	19 121	17 521	18 519
01110	601	Sigurime Shoqërore	4 177	3 167	2 903	3 052
01110	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4 857	3 958	2 458	1 983
01110	606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	100	260	147	0
09120	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3 476	1 569	0	0
Totali		Shpenzime Korrente	37 986	28 075	23 029	23 554

Burimi. AKAP, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

AKAP menaxhon dhe realizon fondet buxhetore vetëm për veprimtarinë e institucionit. Në buxhetin e këtij institucioni nuk janë të përfshira shpenzimet operative apo shpenzimet në investime për shërbimin psiko-social, pasi këto shpenzime janë kryesisht në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

-Sipas të dhënave të paraqitura nga ASCAP për vitet 2021-2023 nga ana e këtij institucioni janë shpenzuar gjithsej rreth 9,779 mijë lekë, për hartim manualesh, udhëzuesish dhe trajnime të ndryshme për punonjësit e shërbimit psiko-social.

3.5 Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit

Gjatë fazës studimore dhe më tej fazës së auditimit në terren, institucionet nën auditim, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar si dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar kanë qenë bashkëpunuese. Ato i kanë janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve, intervistave dhe takimeve konsultuese, si edhe kanë paraqitur në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin e kërkuar. Nga ana e AKAP, informacionet e kërkuara janë azhurnuar disa herë gjatë periudhës së auditimit pasi ka pasur mosrakordime në të dhëna. Vlen të theksohet disponibiliteti i Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, si dhe stafet e shërbimit psiko-social në disa shkolla të përzgjedhura për vizitat në terren, të cilat kanë prezantuar proceset e punës të ndërmarra në kuadër të këtij shërbimi pranë institucioneve ku ato veprojnë, ambienteve të punës, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

4. DETAJET E AUDITIMIT

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me shërbimin psiko-social. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e një menaxhimi më efikas të mangësive në proceset e menaxhimit dhe dhënies së shërbimit psiko-social.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Figura. 3




Tabela. 3 Analiza e Riskut


Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Mungesa e planeve nga institucionet qendrore për monitorimin e veprimtarive lidhur me shërbimin psiko-social.	Risk Strategjik	I lartë
2	Role dhe përgjegjësi institucionale të paqarta.		I lartë
3	Aktivitete të pakta ndërgjegjësuese apo informuese.		I mesëm
4	Mospërshtatje e buxheteve sipas nevojave të shërbimit.	Risk Financiar	I mesëm
5	Kuadër ligjor e rregullator i paplotë dhe jo koherent.	Risk Rregullator dhe Juridik	I lartë
6	Mosmbulim me shërbim psiko-social i të gjitha shkollave.	Risk Operacional	I lartë
7	Mungesa në infrastrukturë për shërbimin psiko-social në shkolla.		I mesëm
8	Struktura përgjegjëse të cilat përmbushin edhe detyra të tjera.		I mesëm
9	Monitorim jo i plotë i proceseve nga ana e institucioneve kryesore përgjegjës.		I lartë
10	Koordinim dhe bashkëveprim i pamjaftueshëm mes aktorëve në proces.		I lartë

4.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”, ka si objektivi kryesor vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëpërmjet identifikimit të mangësive, shkallën e zbatimit të standardeve dhe propozimin e masave korrigjuese për të përmirësuar zbatimin e politikave dhe procedurave në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi nga institucionet publike të arsimit parauniversitar në vend.

4.3 Pyetjet e auditimit

Figura. 4 Piramida e pyetjeve audituese



Pyetja Kryesore: 1. A garantojnë institucionet përgjegjëse shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkolla?

Nënpyetjet:

1.1 A janë strukturat e ngritura të përshtatshme për dhënien e shërbimit psiko-social?

1.2 A e përmbush shërbimi psiko-social rolin e tij për identifikimin dhe adresimin e problematikave në shkolla?

1.3 A janë politikat dhe veprimtaritë e institucioneve në mbështetje të mirëfunksionimit të shërbimit psiko-social?

4.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionimi mbi mirë administrimin e proceseve me synim marrjen e masave të përshtatshme. Auditimi ka një qasje në nivel sistemi duke e parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet nën auditim kanë për shërbimin psiko-social në bazë të fushës së tyre të përgjegjësive shtetërore. Periudha e auditimit është nga 01.01.2020 deri më 30.04.2024. Gjatë këtij auditimi u fokusua në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Rinisë dhe Fëmijëve, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar si dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me njësi të saj të varësisë. Subjektet e përzgjedhur si edhe periudha e auditimit është për të patur një panoramë më të plotë lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit.

5. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

5.1 Pyetja Kryesore: A garantojnë institucionet përgjegjëse shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkollë?

Mesazhi i auditimit

Institucionet përgjegjëse nuk garantojnë shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkollat e arsimit parauniversitar, për të mësuar në një mjedis të sigurtë dhe mbështetës. Një pjesë e shkollave, kryesisht në zonat rurale, nuk mbulohen me shërbim psiko-social. Kabinetet dhe mjetet ndihmëse mungojnë, por, dhe kur ato gjenden, në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë të dedikuara për specialistët e këtij shërbimi. Ofrimi i shërbimit psiko-social për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kryhet sipas parashikimeve. Dokumentet strategjikë në fuqi paraqesin në formë të fragmentuar objektiva për shërbimin psiko-social të cilat shpeshherë janë të mbivendosura. Ndërkohë, kuadri rregullator mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon ky shërbim është i papërshtatur me aktet e tjera ligjore dhe shpesh paraqitet kontradiktor. Megjithatë ndër vite janë ndërmarrë hapa për rritjen e numrit të stafit, shërbimi nuk e përmbush ende funksionin e tij në mënyrë cilësore, për identifikimin dhe adresimin e problematikave psiko-sociale.

5.1.1 Pyetje e auditimit: A janë strukturat e ngritura të përshtatshme për dhënien e shërbimit psiko-social?

Mangësitë kryesore të evidentuara

- Prej vitit 2004 ka pasur zhvillime pozitive rregullatore në drejtim të konsolidimit të shërbimit psiko-social në vend;
- Numri i stafit për shërbimet psiko-sociale në vend gjatë 10 viteve të fundit është rritur;
- Rritja e numrit të punonjësve në shërbimin psiko-social nuk ka sjellë një mbulim uniform në të gjitha DRAP-et dhe ZVAP-et, duke lënë veçanërisht zonat rurale me numrin më të lartë të shkollave pa mbulim me shërbim psiko-social;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar nuk përfitojnë shërbimin psiko-social në përputhje me kërkesat e përcaktuara në bazën ligjore aktualisht në fuqi;
- Kabinetet e krijuara për shërbimin psiko-social nuk janë gjithmonë të dedikuara ekskluzivisht për këtë funksion;
- Procedurat aktuale të rekrutimit nuk garantojnë mbulimin e plotë dhe në kohë të vendeve vakante në shërbimin psiko-social.

Zhvillimi dhe Përmirësimet Rregullatore të Shërbimeve Psiko-Sociale që prej vitit 2004

Shërbimi psiko-social në arsimin parauniversitar ka njohur një mbështetje dhe zhvillim të vazhdueshëm ndër vite, duke kaluar nga një fazë eksperimentale në një politikë më të konsoliduar shtetërore, me rritje të ndjeshme të numrit të specialistëve dhe zgjerim të rolit dhe funksioneve të tij për të përmbushur më mirë nevojat e komunitetit shkollor. Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur zhvillimet kryesore në vite.

Pas viteve '90	Pas ndryshimeve social-ekonomike të kësaj periudhe, u krijua nevoja për profesione të reja që siguronin mirëqenien sociale dhe shëndetin mendor të popullatës. U synua studimi i fenomeneve sociale, çrregullimeve, faktorëve të rrezikut dhe ndihmesa në orientimin e strategjive kombëtare.
2004	Me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 321, datë 11.10.2004, filloi eksperimentimi dyvjeçar i shërbimit psikologjik në sistemin e arsimit parauniversitar. Ky urdhër ligjëroi ngritjen e “Qendrave të shërbimit psikologjik” në të gjitha shkollat e arsimit të detyruar 8/9-vjeçar dhe arsimit të mesëm në zonat urbane të vendit. Qëllimi kryesor ishte shtrirja e shërbimit në sa më shumë shkolla dhe ofrimi i disa shërbimeve që konsideroheshin të domosdoshme. Fillimisht, numri i punonjësve të qendrave ishte i kufizuar në 140 në rang vendi. Shpërndarja e specialistëve u bë sipas këtyre përmasave: <ul style="list-style-type: none">• Në shkollat 8/9-vjeçare: 1 specialist për 2000–2500 nxënës.• Në shkollat e mesme: 1 specialist për 1800–2000 nxënës. Eksperimentimi përfshiu vitet shkollore 2004–2005 dhe 2005–2006.
2005–2006	U realizua faza eksperimentale dyvjeçare e funksionimit të shërbimit psikologjik në shkolla. Kjo fazë shërbeu për vlerësimin e nevojave reale, testimin e modelit dhe mbledhjen e përvojës për shtrirjen më të gjerë.
2008	Me Urdhrin nr. 170, “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”, ish-Ministria e Arsimit dhe Shkencës theksoi rëndësinë e shtrirjes së këtij shërbimi në të gjithë sistemin parauniversitar. Eksperimenti dyvjeçar u kthye në politikë të mirëfilltë institucionale.
2012	Miratohet Ligji nr. 69/2012 për Arsimin Parauniversitar. Neni 20 i ligjit sanksionon kalimin nga një shërbim vetëm psikologjik në një shërbim psiko-social, duke zgjeruar target-grupin e tij. Ligji përcakton që institucionet arsimore vendore duhet të sigurojnë shërbim psiko-social për nxënësit dhe punonjësit e institucioneve arsimore. Shërbimi përfshin trajtimin e problematikave, vlerësimin e rasteve dhe hartimin e programeve parandaluese sipas nevojave të komunitetit shkollor.
2013	Me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 344, datë 19.08.2013, u përcaktua mënyra e funksionimit të njësive të shërbimit psiko-social. Çdo Drejtori Arsimore/Zyrë Arsimore ngriti njësinë e shërbimit, e cila


	<p>përbëhej nga psikologë dhe punonjës socialë. Numri i tyre përcaktohej sipas numrit të nxënësve në institucionet arsimore.</p> <p>Shpërndarja e punonjësve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 psikolog/punonjës social për 3000–3500 nxënës të kopshteve dhe arsimit bazë. • 1 për 2800–3500 nxënës të arsimit të mesëm të lartë. • 1 për 2500–3000 nxënës të arsimit fillor dhe të mesëm. • 1 për 200 nxënës të arsimit special.
2015	Me ligjin nr. 163/2014, profesioni i punës sociale u përfshi në listën e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Ky zhvillim konsolidoi statusin profesional të punonjësve socialë.
2016	Miratohet ligji nr. 40/2016, i cili rregullon me ligj figurën e psikologut. Ky hap i dha bazë më të fortë ligjore dhe standard profesional rolit të psikologëve në institucionet arsimore.
2018	Me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të datës 3 prill 2018, u përcaktua se: <ul style="list-style-type: none"> • Në institucionet e arsimit të mesëm të lartë të sigurohet një psikolog dhe një punonjës social për 1800–2300 nxënës. • Për çdo institucion të arsimit të mesëm të llojit gjimnaz me mbi 700 nxënës të sigurohet një psikolog ose një punonjës social.
2020	Me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, u morën masa që ndikuan në rritjen e numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social. Ky zhvillim lidhej me detyrimet ligjore dhe nevojat e komunitetit shkollor.
Në vijim	Si rezultat i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në vite, numri i psikologëve dhe punonjësve social është rritur vazhdimisht. Shërbimi është zgjeruar për të ofruar trajtim problematikash, këshillim individual, aktivitete parandaluese dhe edukuese për nxënësit dhe stafin e institucioneve arsimore.

Burimi: MAS, Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Për periudhën 2014 – 2024 numri i stafit për shërbimet psiko - sociale paraqet trend në rritje.

Sikurse evidentohet edhe më sipër, me miratimin e Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social” (shih infografikun më poshtë), i ndryshuar, numri i psikologëve dhe punonjësve social për çdo njësi shërbimi, i cili kushtëzohet nga numri i nxënësve në shkollë, pësoi sërish një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme.

Figura. 5 Kriteret për numrin e punonjësve psiko-socialë në shkolla




Burimi: Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar.

Punoi: Grupi i Auditimit.

Sipas këtij urdhri, për çdo shkollë me 500 – 700 nxënës duhet të punësohet të paktën një punonjës në shërbimin psiko – sociale. Për çdo shkollë me më shumë se 700 nxënës duhet të punësohen të paktën 2 punonjës të shërbimit psiko – social. Në shkollat ku ka nxënës me aftësi të kufizuara, shtohet një punonjës në shërbimin psiko – social nëse numri i tyre është të paktën 10 ose më tepër. Në rastet kur ka shkolla të cilat nuk e arrijnë numrin minimal të nxënësve (pra 500 nxënës), atëherë një punonjës i shërbimit psiko – social i punësuar do të mbulojë më shumë se një shkollë deri sa të arrihet të paktën numri minimal i nxënësve (pra 500 nxënës ose më shumë) në varësi të rasteve.

Sikurse paraqitet në grafikun më poshtë, gjatë periudhës 2014 - 2024, numri i psikologëve dhe punonjësve socialë të angazhuar në shërbimin psiko - social ka një trend rritës. Në vitin shkollor 2023 - 2024, në këtë shërbim janë përfshirë gjithsej 824 punonjës, ose 558 më shumë krahasuar me vitin shkollor 2014 - 2015, kur numri i tyre ishte vetëm 266. Kjo përfaqëson një rritje prej 68% të kapaciteteve të shërbimit brenda dhjetë vitesh, duke reflektuar një përmirësim të dukshëm në aspektin numerik dhe mbulues të tij.

Grafik nr. 1, Numri i punonjësve psiko – socialë për periudhën 2014 - 2024




Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Kjo rritje është realizuar gjatë viteve (sikurse evidentohet edhe në fillim të trajtimit të kësaj pyetjeje) nëpërmjet uljes së raportit psikolog/punonjës social për numër nxënësish, duke mundësuar përfshirjen e më shumë specialistëve në sistem. Një moment kyç në këtë drejtim ishte viti 2020, kur u miratua Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020, i cili ndikoi ndjeshëm në shtimin e numrit të figurave profesionale në shërbim. Siç tregohet edhe në grafikun më sipër, në vitin shkollor 2023 - 2024 janë angazhuar 824 punonjës, që përbën një rritje prej 432 punonjësish ose rreth 52% më shumë krahasuar me vitin 2020 - 2021.

Kritja e numrit të punonjësve në shërbimin psiko – social nuk ka siguruar mbulim uniform në të gjitha DRAP – et dhe ZVAP – et.

Megjithatë, pavarësisht rritjes së numrit të punonjësve në shërbim, nga analizimi i të dhënave është vërejtur se ka raste kur nuk sigurohet mbulim i mjaftueshëm me punonjës në shërbim. Për këtë është bërë një renditje e DRAP – eve dhe ZVAP – eve përkatëse duke analizuar numrin e shkollave për punonjës të shërbimit psiko – social, qoftë ai psikolog apo punonjës social. Nga analizimi i këtyre të dhënave për vitin 2023 – 2024 strukturat më problematika kanë rezultuar si më poshtë:


Grafik nr. 2 Nr. Shkollash për punonjës të shërbimit psiko – social sipas DRAP – eve (2023 – 2024)



Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Pra sikurse, mund të vihet re dhe nga grafiku i mësipërm, në rang vendi mesatarisht një punonjës i shërbimit psiko – social mbulon 1.7 shkolla . Në nivel DRAP – i, situata paraqitet më problematike në DRAP – in e Fierit dhe atë të Korçës, ku një punonjës i shërbimit psiko – social mbulon respektivisht 2.6 shkolla në Fier dhe 2 shkolla në Korçë. Situata paraqitet më mirë në DRAP – in e Durrësit dhe atë të Lezhës, ku respektivisht një punonjës i shërbimit mbulon 1.2 shkolla në Durrës dhe 1.8 në Lezhë (+0.1 pikë më tepër se sa mesatarja kombëtare). Nëse bëjmë një analizë më të thelluar të këtyre të dhënave rezulton se në nivel ZVAP – i ka disa ZVAP që nuk kanë pothuajse fare mbulim me figura profesionale të shërbimit psiko – social. Më konkretisht situata në nivel ZVAP – i paraqitet si më poshtë:

Grafiku nr. 3 Nr. Shkollash për punonjës të shërbimit psiko – social sipas ZVAP – ve të (2023 – 2024)



Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Sikurse mund të vërehet nga grafiku i mësipërm, në DRAP Fier, situata paraqitet më problematike, pasi në ZVAP Finiq – Dropull shërbimi rezulton i pa ngritur. Aty ende nuk ka asnjë punonjës psikolog/punonjës social për 8 shkollat e ZVAP – it. E ngjashme është edhe situata e ZVAP Selenicë dhe Tepelenë – Memaliaj ku respektivisht në totalin e 18 shkollave të Selenicës dhe 14 shkollave të zonës Tepelenë – Memaliaj është punësuar vetëm 1 punonjës për secilin shërbim.

Në ngjashmëri me Fierin, edhe në DRAP – in Korçë situata paraqitet me problematika në mbulim, sidomos në ZVAP – et e Dimalit (3.5 shkolla për punonjës të shërbimit) dhe Maliqit (3 shkolla për punonjës të shërbimit).

Po kështu edhe në DRAP - et Durrës e Lezhë, ku ka disa ZVAP – e të cilat nuk kanë mbulim të mjaftueshëm, si në rastin e ZVAP - eve Bulqizë e Dibër (3.2 shkolla për punonjës të shërbimit), ZVAP – et Malësi e Madhe, Pukë – Fushë Arrës, Tropojë me 3 shkolla për punonjës të shërbimit.


Në analizën kombëtare, dhjetë ZVAP-et me numrin më të lartë të shkollave të pambuluara janë të përqendruara kryesisht në jug të vendit dhe në zona rurale, ku problemet e aksesueshmërisë, mungesës së stafit dhe distancës nga qendrat urbane janë më të theksuara. Finiq – Dropull dhe Selenicë qëndrojnë në krye të listës me mungesë pothuajse të plotë të shërbimit.

Të dhënat tregojnë një ndarje të thellë mes zonave urbane dhe rurale sa i përket aksesit në shërbimin psiko-social në arsimin parauniversitar. Kjo ndarje përforcohet nga distanca nga qendrat e mëdha, duke e bërë të domosdoshme hartimin e politikave të synuara për përmirësimin e barazisë në akses.

Numri i nxënësve në arsimin parauniversitar publik në vend paraqet dinamika të cilat kanë ndikim edhe në ofrimin e shërbimit psiko-social.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në arsimin parauniversitar në vend studiojnë mesatarisht 360,650 nxënës çdo vit, me tendencë në rënie të numrit. Për vitin shkollor 2023 - 2024 rezultojnë 51,328 nxënës më pak se periudha shkollore 2019 - 2020 ose 13.3% më pak. Aktualisht, gjithmonë e më tepër nxënës po i drejtohen arsimit privat, ndërkohë që numri i nxënësve në arsimin publik po reduktohet mestarisht me 4% çdo vit.


Grafiku nr. 4 Ecuria e numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar sipas viteve shkollorë



Burimi: MAS, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

Pjesa më e madhe e nxënësve aktualisht studion në shkolla urbane. Në vitin 2020 vetëm 38% e nxënësve studionin në shkollat rurale ndërsa në vitin 2024 ky raport ka shkuar në 35%, pra gjithmonë e më tepër tendenca paraqitet rritëse në shkollat urbane.

Grafiku nr. 5 Trendi i nxënësve që studiojnë në zonat rurale dhe urbane sipas viteve shkollorë



Burimi: MAS, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

Në totalin e nxënësve publik dhe privat së bashku peshën kryesore e zë arsimit bazë me rreth 77% dhe më tej vjen arsimit mesëm i përgjithshëm me rreth 22% dhe rreth 1% arsimit mesëm i orientuar.

Nga ana tjetër nëse shohim trendin vitet e fundit numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në shkollat ka pësuar rritje të konsiderueshme. Megjithatë, mbulimi i plotë me shërbim psiko-social nuk garantohet ende në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar. Emigrimi dhe ndryshimet e vazhdueshme demografike kanë patur ndikimin e tyre në uljen e numrit të nxënësve kryesisht në zonat rurale. Është rritur numri i shkollave me pak nxënës, çka ndikon edhe në rritjen e numrit të shkollave që mbulojnë nga një punonjës i shërbimit psiko-social.

Shërbimi psiko – social nuk siguron mbulim me shërbim për rreth 1/4 e shkollave në rang vendi.

Nga të dhënat e grumbulluara për shërbimin psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar evidentohet se, për vitin shkollor 2023-2024 rezultoi se:

Prej 1356 shkollave në vend, rreth 1/4 e tyre ose 334 shkollat nuk kanë mbulim me punonjës socialë apo psikologë, ose rreth 92,991 nxënësish të cilëve nuk u është ofruar mbështetja e nevojshme psiko-sociale. Përgjithësisht, nxënësit e shkollave në zonat rurale, aty ku edhe mbulimi është pak më i ulët, përballen me më shumë sfida.

Në zonat rurale kjo gjendje është pasojë e disa faktorëve kompleksë:

- Vështirësi në rekrutimin dhe mbajtjen e specialistëve në zonat e thella për shkak të kushteve të vështira jetese dhe mungesës së motivimit ekonomik.
- Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor për të ofruar shërbime të përbashkëta ndërskollore.
- Përqendrim i ulët institucional dhe monitorimi më i dobët, që çon në zbatueshmëri më të ulët të politikave sociale në këto rajone.

Në zonat urbane mbulimi me punonjës socialë dhe psikologë në shkollat është në një nivel relativisht të mirë. Kjo gjendje lidhet me faktorë si:

- Disponueshmëria më e lartë e profesionistëve të fushës në qytete.

- Infrastrukturë më e mirë dhe kushte më të favorshme për zhvillimin e praktikave psiko-sociale.
- Më shumë ndërhyrje nga institucionet qendrore dhe lokale për shkollat urbane.
- Aksesimi në mundësi të zhvillimit profesional.

Megjithatë, edhe në zonat urbane, disa shkolla përballen me sfida për të garantuar mbulim të vazhdueshëm, veçanërisht në periferi të qyteteve të mëdha ose në zona me rritje të shpejtë demografike.

Për fëmijët me aftësi të kufizuar në arsimin parauniversitar nuk ka mbulim me shërbim psiko – social sikundër kërkohet nga baza ligjore aktualisht në fuqi.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, numri i punonjësve të shërbimit psiko - social është në varësi të numrit të nxënësve dhe numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar (për çdo 10 nxënës me AK duhet të shtohet një punonjës në shërbim).

Në shkollat ku ofrohet shërbimi psiko – social, pjesa më të madhe të nevojave të nxënësve me aftësi ndryshe, duhet të mbulohet nga mbështetja psiko - emocionale dhe vlerësimi i ecurisë së secilit nxënës kryesisht nëpërmjet stafit arsimor dhe mësuesit ndihmës, por edhe nëpërmjet shërbimit psiko - social.

Gjatë auditimit ka rezultuar se për këtë kategori nxënësish nuk është siguruar mbulim, pasi aktualisht nuk janë rekrutuar punonjës shtesë në shërbimin psiko – social në rastet kur ka të paktën 10 fëmijë me AK sikundër kërkohet nga Urdhri nr. 313. Gjithashtu, në disa institucione arsimore të arsimit të zakonshëm ka rritje të ndjeshme të numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara, duke arritur deri në 35 nxënës me AK në një institucion të vetëm. Në këto raste, për të mbështetur disi shërbimin janë të punësuar vetëm 2 punonjës të shërbimit psiko - social, të cilët, përveç mbështetjes që ofrojnë për gjithë nxënësit e institucionit dhe stafin arsimor, kanë në ngarkim edhe ofrimin e shërbimit për këtë kategori specifike të nxënësve⁶. Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga AKAP aktualisht në vendin tonë ka rreth 4686 nxënës me aftësi të kufizuara për të cilët nuk ofrohet asnjë mbështetje shtesë.

Nga të dhënat që kemi, mund të shohim sesi zonat e ndryshme arsimore në Shqipëri kanë një shpërndarje të nxënësve me nevoja të veçanta (AK).

Grafik nr. 6 Nxënësit me AK sipas ZVAP – ve 2023 - 2024

	Totali i nxënësve	Nxënës me AK	% AK ndaj totalit
Tiranë	68,806	1,392	2.02
Fier	10,498	177	1.69
Elbasan	13,775	216	1.57
Durrës ZVAP	18,798	286	1.52
Vlorë	8,017	204	2.54
Korçë	7,469	120	1.61
Lezhë	7,397	91	1.23

Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i Auditimit

⁶ Sipas raportit narrativ të paraqitur nga AKAP për shërbimin psiko-social.

Në total, ZVAP Tiranë është qendra më e madhe arsimore në vend dhe ka numrin më të madh të nxënësve, me rreth 68,806 nxënës nga të cilët 1,392 janë nxënës me AK, duke përbërë rreth 2.02% të gjithë nxënësve në këtë zonë. Në anën tjetër, ZVAP Vlorë ka përqindjen më të madhe të nxënësve me AK (2.54%), duke treguar se, edhe pse ka më pak nxënës në total (8,017), numri i fëmijëve me AK është relativisht më i lartë krahasuar me zonat e tjera.

ZVAP Lezhë ka përqindjen më të ulët, me vetëm 1.23% të nxënësve që kategorizohen me AK. Megjithatë evidentohet nevoja për verifikime të dhënash nga ana e strukturave përgjegjëse, nëse në këtë rajon ka më pak raste të identifikuar ose të raportuara. Një element i rëndësishëm është se, edhe në zonat me më pak nxënës, si rasti i ZVAP Finiq - Dropull, ka 2 nxënës me AK. Kjo zonë ka pak shkolla dhe popullatë të vogël në zonat rurale e cila nuk mbulohet me shërbim psiko-social.

Kabinetet e shërbimit psiko – social të krijuara nuk janë gjithmonë të dedikuar për këtë shërbim.

Analiza e të dhënave të mbledhura nga grupi i auditimit në nivel DRAP dhe ZVAP lidhur me ambientet fizike të vëna në dispozicion të shërbimit psiko-social (SHPS) në institucionet arsimore parauniversitare (të quajtura ndryshe kabinete të shërbimit psiko – social) nxjerr në pah disa problematika strukturore që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë, efektivitetin dhe integritetin e këtij shërbimi.

Tabela nr. 4, Shkollat pa kabinete të shërbimit psiko – social (gjendja viti shkollor 2024-2025)

DRAP	Nr. Shkollash	Total Kabinete	Kabinete të dedikuar	Kabinete të përbashkët	Nr. Shkollash pa kabinete	% e shkollave pa kabinete
DRAP Durrës	196	103	79	24	93	47%
DRAP Tiranë	231	144	107	37	87	38%
Drap Fier	296	230	204	26	66	22%
DRAP Korçë	376	170	124	46	206	55%
DRAP Lezhë	257	4	3	1	253	98%
TOTAL	1356	651	517	134	705	52%

Burimi AKAP⁷, Përpunoi: Grupi i auditimit

Pavarësisht masave të marra për të krijuar kabinetet për SHPS, ka ende hapësirë për më shumë angazhim, pasi numri i shkollave pa kabinete të ngritura mbetet ende i lartë, 705 shkolla ose rreth 52% e tyre në rang vendi nuk kanë hapësirën e dedikuar për punonjësit e shërbimit psiko – social. Në veçanti gjendja paraqitet më problematike në DRAP Lezhë, në të cilin janë ngritur vetëm 4 kabinetet për SHPS në totalin prej 257 shkollave. Problematika mbeten gjithashtu:

1. Mungesa e standardizimit të hapësirave dhe përdorimi i përbashkët i kabineteve.

Të dhënat tregojnë se në shumë raste, kabinetet që figurojnë si pjesë e infrastrukturës në funksion të SHPS nuk janë të dedikuara ekskluzivisht për punonjësit socialë dhe psikologët e shkollave. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë ambiente të përbashkëta me aktorë të tjerë jo-mësorë, si mjekët e shkollës, oficerët e sigurisë apo stafi administrativ.

Ky përdorim i përbashkët ndikon negativisht në:

- ✓ sigurimin e konfidencialitetit në ndërhyrjet psiko-sociale;

⁷ Të dhënat e paraqitura nga AKAP përfaqësojnë gjendjen aktuale të kabineteve, pas ndryshimeve strukturore ku DRAP-i Durrës u nda në dy DRAP-e përkatësisht, Durrës dhe Tiranë.


- ✓ krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe të qetë për zhvillimin e seancave individuale apo grupe me nxënësit;
- ✓ ruajtjen e profesionalizmit dhe respektimit të etikës në raport me rastet e ndjeshme që trajton ky shërbim.

2. Implikime për cilësinë e shërbimit dhe barazinë në akses.

Mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe e standardeve të unifikuara për funksionimin e SHPS rrezikon të dëmtojë jo vetëm cilësinë e ndërhyrjes profesionale, por edhe besueshmërinë e vetë shërbimit tek nxënësit dhe familjet. Ajo çfarë përbën një shqetësim të veçantë është pabarazia territoriale, ku fëmijët në zona të thella rurale apo me burime të kufizuara, përballen me pengesa më të mëdha në aksesin e barabartë ndaj këtij shërbimi bazë.

Edhe pse në shumë raste ekzistojnë ambiente të caktuara për zhvillimin e shërbimit psiko-social në shkolla, cilësia dhe ekskluziviteti i këtyre ambienteve mbetet i kufizuar.

Grafik nr. 7 Kabinetet për SHPS



Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i Auditimit

DRAP Fier paraqet performancën më të mirë në rang kombëtar sa i takon infrastrukturës mbështetëse për shërbimin psiko - social. Nga 230 kabinete të raportuara gjithsej, 204 janë të dedikuara ekskluzivisht për psikologët dhe punonjësit socialë, që përbën 89% të totalit. Ky nivel i lartë përfaqësimi pasqyron një angazhim të qartë për ofrimin e kushteve funksionale dhe të përshtatshme për këtë shërbim.

DRAP Tiranë, ndonëse përballlet me sfida të konsiderueshme për shkak të dendësisë urbane dhe kompleksitetit social, ruan një nivel të mirë të infrastrukturës së dedikuar. Nga 144 kabinete të raportuara, 107 janë të dedikuara dhe 37 janë të përbashkëta, çka rezulton në një përqindje

të kënaqshme të kabineteve të dedikuara (74% prej tyre). Kjo përqindje tregon një progres domethënës, por ende prania e një numri të lartë kabinetesh të përbashkëta ngre shqetësime për cenimin e konfidencialitetit, veçanërisht në rastet e ndjeshme si bullizmi, dhuna në familje apo problemet emocionale. Kjo situatë nënvizon nevojën për rritjen e hapësirave të dedikuara dhe të sigurta brenda shkollave.

DRAP Korçë paraqet një situatë të qëndrueshme, me 170 kabinate gjithsej, nga të cilat 124 janë të dedikuara dhe 46 të përbashkëta. Me një përqindje 73% të kabineteve të dedikuara, rajoni mbetet në një nivel pozitiv, por me nevojë për përmirësime, sidomos në drejtim të reduktimit të ndarjes së hapësirave me aktorë të tjerë jo-mësimorë.

DRAP Durrës raporton 103 kabinate në total, nga të cilët 79 janë të dedikuara për SHPS dhe 24 të përbashkëta, duke e vendosur përqindjen e kabineteve të dedikuara në 77%. Ky tregues sugjeron se ndonëse situata është relativisht e mirë, ka ende hapësirë për përmirësim, veçanërisht në krijimin e ambienteve të ndara dhe konfidenciale për ofrimin e shërbimeve sensitive ndaj nxënësve.

DRAP Lezhë evidentohet për mungesë të theksuar të infrastrukturës. Janë raportuar vetëm 4 kabinate, nga të cilat 3 janë të dedikuara dhe 1 i përbashkët, duke e çuar përqindjen e dedikimit në 75%. Pavarësisht se kjo përqindje është në përputhje me mesataren kombëtare, volumi i ulët i hapësirave mbështetëse reflekton një nevojë të menjëhershme për investime në rritjen e kapaciteteve infrastrukturore në këtë qark.

Procedura e rekrutimit të punonjësve të shërbimit psiko – social nuk siguron mbulimin e duhur të vendeve vakante.

Për sa i përket procedurës së rekrutimit të psikologëve shkollorë dhe punonjësve sociale parashikuar nga Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar, duhet theksuar se DRAP-et organizojnë procedurën e konkursit për të gjitha pozicionet vakante të shërbimit psiko - social tek ZVAP - et në varësi. Para fillimit të vitit shkollor, DRAP – et publikojnë hapjen e procedurave për mbulimin e vendeve vakante me qëllim punësimin e specialistëve të shërbimit me kontrata të përhershme. Nëse në fazën e parë, ende mbeten vende vakante të pa plotësuara, sipas urdhrin të sipërcituar, pozicionet e ngelura vakante mbulohen me kandidatë që kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve bachelor në fushën e psikologjisë ose punëve sociale dhe kontrata e tyre zgjat deri në përfundim të vitit shkollor.

Gjatë auditimit u evidentua se, për periudhën 2020 – 2023, vendet vakante në total kanë qenë 92 psikologë/punonjës social. Nëse bëjmë një llogaritje të thjeshtë të numrit minimal të nxënësve që mund të mbulonte secili prej këtyre punonjësve po të ishte pjesë e sistemit, mesatarisht për të tre vitet, rezulton se rreth 15,000 nxënës çdo vit nuk kanë përfituar shërbim për shkak të mos punësimin të tyre.

Kjo situatë ka ardhur edhe si pasojë e faktit se, referuar bazës rregullatore aktualisht në fuqi, sidomos për figurën e psikologut, MAS ka miratuar kriteret shtrënguese pranimi për ta, duke pranuar në fazën e parë të rekrutimit vetëm psikologët shkollorë me nivelin arsimor Master. Në rast se konkursi për kontrata të përhershme nuk rezulton i suksesshëm, në konkurset në vijim të vitit shkollor për mbulim me kontrata të përkohshme kriteret nuk janë më shtrënguese, duke pranuar edhe aplikimet e kandidatëve që kanë mbaruar minimalisht ciklin e parë të studimeve bachelor në fushën e psikologjisë ose punëve sociale.

Kjo situatë nuk favorizon konsolidimin e këtij sistemi, si nga këndvështrimi i plotësimin të vendeve vakante, ashtu edhe nga këndvështrimi i cilësisë së shërbimit. Nëse kriteri shtrëngues psikolog shkollor me Master është i rëndësishëm për cilësinë e shërbimit, ai duhet të vijojë të qëndrojë i tillë edhe kur konkursi shpallet për kontrata të përkohshme, e jo vetëm për ato të përhershme. Gjithashtu, referuar edhe analizës së bërë më sipër mbi diferencat dhe karakteristikat e ZVAP – eve urbane dhe rurale, lehtësisht kuptohet se kriteri shtrëngues, në veçanti për figurën e psikologut, penalizon më së tepërmi ZVAP – et rurale.

1- Gjetje nga auditimi: Numri i punonjësve të shërbimit psiko - social në arsimin parauniversitar në vitin shkollor 2023 – 2024 është 824 punonjës dhe, krahasuar me vitin shkollor 2014 – 2015, është rritur me 558 punonjës. Rritja më e madhe ka ndodhur në 5-vjeçarin e fundit (2019 – 2024) gjatë të cilit numri i stafit të shërbimit psiko-social është rritur. Megjithatë, mbulimi i shkollave me shërbim mbetet i pabarabartë në nivel kombëtar. Pavarësisht rritjes së numrit të punonjësve psiko-socialë, në disa ZVAP, si Finiq–Dropull, mungon plotësisht stafi psiko-social, ndërsa në zona të tjera si Selenicë dhe Tepelenë – Memaliaj, një punonjës mbulon përkatësisht 18 dhe 14 shkolla. Në ZVAP Bulqizë dhe Dibër, një punonjës mbulon deri në 3.2 shkolla, në tejkalim të ndjeshëm të mesatares kombëtare prej 1.7 shkolla për punonjës. Kjo mbingarkesë është veçanërisht e theksuar në zonat rurale, malore dhe me popullatë të shpërndarë, duke kufizuar ndjeshëm aksesin e nxënësve në mbështetjen psiko-sociale dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë dhe barazinë e shërbimit arsimor.

2- Gjetje nga auditimi: Të dhënat e auditimit evidentojnë se, për vitin shkollor 2023-2024 rreth ¼ e shkollave në rang vendi nuk kanë pasur shërbim psiko-social. Pra rreth 92,991 nxënës nuk kanë marrë mbështetjen e nevojshme psiko-sociale. Ky fenomen rezulton më i përhapur në zonat rurale krahasimisht me ato urbane, ku edhe disponueshmëria është më e lartë e profesionistëve të fushës, infrastruktura më e mirë dhe kushte më të favorshme për zhvillimin e praktikave psiko-sociale. Ndërhyrjet nga institucionet qendrore dhe lokale për shkollat urbane janë më prezente dhe aksesin në mundësi të zhvillimit profesional më i pranishëm. Ndërkohë, për zonat rurale haset vështirësi në rekrutimin e specialistëve, për shkak të mungesës së incentivave dhe bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe kapaciteteve të kufizuara për mbikëqyrje dhe zbatim të politikave në nivel vendor. Kjo pabarazi strukturore rrezikon të thellojë më tej hendekun arsimor dhe social midis fëmijëve që jetojnë në zona me zhvillim të pabarabartë.

3- Gjetje nga auditimi: Institucionet arsimore parauniversitare nuk ofrojnë mbulim të plotë dhe të përshtatshëm me shërbim psiko-social për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK), pavarësisht kërkesave të përcaktuara në Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar. Ky akt parashikon shtimin e një punonjësi shtesë për çdo 10 nxënës me (AK), por në praktikë ky standard nuk është respektuar. Madje, 50 ZVAP me mbi 10 nxënës me aftësi të kufizuara, nuk kanë të punësuar punonjës shtesë të shërbimit psiko-social sipas përcaktimeve të urdhrin. Në mungesë të burimeve të mjaftueshme njerëzore, mbështetja për këtë kategori të nxënësve mbetet e pjesshme dhe kryesisht realizohet nga mësues ndihmës apo stafi mësimor. Në rang vendi, rreth 4,686 nxënës total me (AK) nuk marrin asnjë lloj mbështetjeje psiko-sociale të strukturuar, çka përbën një mospërputhje të drejtpërdrejtë me kuadrin ligjor dhe dëmton qasjen gjithëpërfshirëse në sistemin arsimor.

4- Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e mbledhura në nivel të drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrave vendore arsimore, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e kabineteve që figurojnë në funksion të shërbimit psiko-social nuk janë të dedikuara ekskluzivisht për këtë qëllim. Ambientet shpesh ndahen me punonjës të tjerë të Institucionit Arsimor si mjekët e shkollës, oficerët e sigurisë apo stafi administrativ. Kjo situatë ndikon negativisht në cilësinë e shërbimit, veçanërisht në garantimin e konfidencialitetit, në krijimin e një mjedisi të qetë dhe të përshtatshëm për ndërhyrje profesionale, si dhe në perceptimin e shërbimit nga nxënësit. Mungesa e standardizimit të hapësirave vërehet në të gjithë vendin, me ndryshime të theksuara ndërmjet qarqeve. P.sh., ndërsa DRAP Fier dhe Tiranë shënojnë përqindje relativisht të larta të ambienteve të dedikuara (89% dhe 74% respektivisht), rajone të tjera si Lezha dhe Korça përballen me mungesa të theksuara si në numër ashtu edhe në cilësi.

Pabarazia territoriale dhe infrastruktura e papërshtatshme kufizon ndjeshëm aksesin dhe cilësinë e mbështetjes psiko-sociale për nxënësit në shumë shkolla.

5- Gjetje nga auditimi: Gjatë viteve 2021–2023, procedurat e ndjekura për rekrutimin e psikologëve dhe punonjësve socialë në shkollat e arsimit parauniversitar nuk kanë siguruar mbulimin e nevojshëm të vendeve vakante, duke lënë pa shërbim rreth 15,000 nxënës në shkallë vendi. Në këtë periudhë janë regjistruar 92 vende vakante, të cilat nuk janë arritur të plotësohen përmes konkursit të rregullt. Sipas bazës rregullatore në fuqi, për pozicionet e përhershme, psikologët duhet të jenë të profilit psikolog shkollor dhe të kenë përfunduar studimet në nivelin master, ndërsa për kontratat e përkohshme lejohet edhe pranimiti i kandidatëve me diplomë bachelor në psikologji apo punë sociale. Kjo ndarje e kritereve krijon standarde të dyfishta dhe cenon qëndrueshmërinë e shërbimit. Kriteri shtrëngues për psikologët me profil të caktuar (shkollor) dhe nivel të lartë arsimor, ndonëse i justifikuar nga nevoja për cilësi, ka ndikuar negativisht në ZVAP-et rurale, ku numri i kandidatëve është i kufizuar dhe pozicionet janë më pak tërheqëse. Si pasojë, shërbimi psiko - social nuk është shtrirë në mënyrë të barabartë në të gjithë vendin, duke rrezikuar cilësinë dhe qasjen në mbështetje për fëmijët dhe komunitetin shkollor që kanë më shumë nevojë për të.

1.Konkluzioni: Pavarësisht përmirësimeve rregullatore dhe rritjes së stafit, shërbimi psiko-social në arsimin parauniversitar vijon të jetë i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, me mbulim të pamjaftueshëm veçanërisht në zonat rurale dhe për nxënësit me nevoja të veçanta. Mungesa e procedurave efektive të rekrutimit, e kabineteve të dedikuara dhe mbingarkesa e stafit cenojnë cilësinë, aksesin dhe barazinë në ofrimin e këtij shërbimi, duke rrezikuar thellimin e pabarazive sociale dhe arsimore.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me strukturat e varësisë, të ndërmarrë një analizë të plotë vlerësuese të shpërndarjes aktuale të punonjësve të shërbimit psiko-social, me qëllim ribalancimin dhe optimizimin e burimeve njerëzore në përputhje me kriteret ligjore dhe nevojat specifike të çdo zone arsimore.

Brenda datës 30.06.2026

2.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, të hartojë dhe zbatojë plane ndërhyrjeje për mbulimin e zonave kritike, ku mungon ose është e kufizuar prania e shërbimit psiko-social. Në këtë kuadër të synohet edhe përfshirja e pushtetit vendor për të siguruar akses të barabartë për të gjithë nxënësit në këtë shërbim.

Brenda datës 30.06.2026

2.2 Rekomandimi: Ministri i Arsimit nëpërmjet një grupi pune, të vlerësojë nevojën për masa të veçanta, për të përmirësuar rekrutimin dhe qëndrueshmërinë e punonjësve psiko-socialë në zonat rurale, përmes paketave stimuluese, lehtësirave për akomodim dhe mundësive të zhvillimit profesional. Mbi bazën e këtij vlerësimi të bëjë edhe adresimin për përmbushjen e tyre.

Brenda datës 30.06.2026

3.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me strukturat e varësisë, Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, të marrë masa për të garantuar mbulimin me shërbim psiko - social të shkollave në përputhje me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Brenda datës 30.06.2026

4.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat arsimore lokale, të hartojë dhe zbatojë standarde të detyrueshme infrastrukturore për ambientet e shërbimit psiko-social, duke garantuar që çdo institucion arsimor të ketë kabinete të posaçme, të dedikuara dhe të pajisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e seancave individuale dhe grupore.

Brenda datës 30.06.2026

5.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me strukturat e varësisë, Agjencinë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të rishikojë kriteret e rekrutimit të punonjësve të shërbimit psiko - social, duke harmonizuar kërkesën për cilësi me nevojat reale në terren, dhe të sigurojnë mbulimin e pozicioneve vakante, veçanërisht në zonat rurale.

Për vitin shkollor 2025 – 2026 dhe në vijimësi

5.1.2 Pyetje e auditimit: A e përmbush shërbimi psiko-social rolin e tij për identifikimin dhe adresimin e problematikave në shkolla?

Mangësitë kryesore të evidentuara

- Shërbimi psiko-social aktualisht paraqet një qasje reaguese në vend të ndërhyrjes parandaluese;
- Shërbimi psiko-social përballlet me sfida në lidhje me realizimin e punës në përditshmëri;
- Nuk ka supervizimit të strukturuar dhe efektiv për punonjësit e shërbimit psiko-social;
- Nuk ka një metodologji të standardizuar supervizimi për psikologët dhe punonjësit social;
- Situatat psiko-sociale në nivel kombëtar nuk analizohen dhe nuk ka një mënyrë të përcaktuar raportimi;
- Roli i psikologut dhe punonjësit social në shërbimin psiko-social në shkolla trajtohet i barasvlershëm.

Shërbimi psiko-social në shkollat e Shqipërisë është një mekanizëm i integruar në sistemin arsimor parauniversitar, i krijuar për të garantuar mbështetje të specializuar për nxënësit në aspektin emocional, social dhe akademik. Ky shërbim synon të identifikojë në kohë faktorët që pengojnë përfshirjen dhe mirëqenien e nxënësve në procesin mësimor, të ofrojë këshillim dhe ndërhyrje për parandalimin e sjelljeve të rrezikshme, dhe të promovojë një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës në shkollë. Shërbimi kontribuon në rritjen e aftësive të nxënësve për përballimin e vështirësive personale, zhvillimin e aftësive sociale dhe menaxhimin e emocioneve, duke ndihmuar kështu edhe në përmirësimin e performancës së tyre akademike. Funkcionimi i këtij shërbimi mbështetet në bazë të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon përfshirjen e mbështetjes psiko-sociale në institucionet arsimore, si dhe në aktet rregullatore, që përcaktojnë organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Shërbimit Psiko-social në shkollat e arsimit parauniversitar. Në thelb, shërbimi psiko-social përfaqëson një urë lidhëse mes shkollës, familjes dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës, duke luajtur një rol kyç në parandalimin e braktisjes shkollore, reduktimin e bullizmit, adresimin e traumave, si dhe në forcimin e mbështetjes psikologjike për fëmijët në nevojë.

✓ Por pse është kaq e rëndësishme prania e këtij shërbimi?

Sepse për shumë fëmijë dhe të rinj, psikologu i shkollës apo punonjësi social është i vetmi person që mund t’i dëgjojë pa i gjykuar. Është personi që mund të kuptojë pasojat e një fyerjeje të përsëritur, një ngacmimi të fshehtë ose një përqeshjeje të përditshme, një gjendje ankthi ose

mospranimi në shkollë. Është ai që mund të dallojë kur një nxënës është në rrezik për të bërë diçka të dëmshme ndaj vetes apo të tjerëve⁸.

Pavarësisht se në një pjesë të konsiderueshme të rasteve (rreth 81%) bëhet njoftimi i prindërve dhe përfshirja e psikologut/punonjësit social, mungesa e një ekipi të mjaftueshëm dhe funksional të shërbimit psiko-social në shkolla, kufizon ndjeshëm ndikimin e ndërhyrjeve dhe zgjidhjen e problemeve sociale.

Aktualisht, një specialist i fushës mbulon disa shkolla, çka nuk mundëson në fakt të ndjekë në mënyrë sistematike rastet, të realizojë ndërhyrje parandaluese apo të ndërtojë marrëdhënie afatgjata mbështetëse me nxënësit në mënyrë që kjo ndërhyrje të ketë rezultat.

Shërbimi psiko-social aktualisht paraqet një qasje reaguese në vend të ndërhyrjes parandaluese.

Zbatimi praktik i shërbimit psiko-social në arsimin parauniversitar has kufizime të rëndësishme që komprometojnë aftësinë e tij për të përmbushur funksionin e vet thelbësor, atë të ndërhyrjes së hershme dhe mbështetjes sistematike të nxënësve në vështirësi. Nga analiza e dokumentacionit, vëzhgimet në terren dhe intervistat e zhvilluara me drejtues institucionesh arsimore, specialistë të shërbimit psiko-social dhe përfaqësues të Zyrave Vendore të Arsimit në qarqet Durrës, Fier, Lezhë, Korçë dhe Tiranë, grupi i auditimit evidentoi se, ky shërbim operon kryesisht mbi bazë ndërhyrjesh të karakterit reagues, të cilat aktivizohen vetëm pas shfaqjes së dukshme të problematikave tek nxënësit.

Një ndër faktorët përcaktues të kësaj situatë është mungesa e mbulimit të qëndrueshëm të shkollave me specialistë të dedikuar të shërbimit psiko-social. Në shumë raste, një psikolog apo punonjës social është përgjegjës për disa shkolla njëkohësisht, gjë që kufizon ndjeshëm praninë e tij të përditshme në secilin institucion. Kjo mungesë fizike nuk lejon krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me nxënësit, komunitetin pedagogjik dhe prindërit, dhe si rrjedhojë pengon ndjeshëm identifikimin në kohë të sinjaleve të para të vështirësive psiko-emocionale apo sociale.

Nga ana tjetër, planifikimi dhe përdorimi i ndërhyrjeve të strukturuar individuale, përmes planeve të personalizuar të mbështetjes për nxënësit në vështirësi, rezultoi të jetë i jo gjithmonë i mundur për t'u realizuar. Sipas verifikimeve në shkollat e përfshira në auditim, planet individuale të ndërhyrjes hartohen në mënyrë sporadike dhe vetëm në raste të avancuara, si p.sh. në situata konflikti të rëndë, episode të rënda ankthi apo depresioni, apo shfaqje të dhunshme të sjelljes. Mungesa e një protokolli standard të detyrueshëm në nivel kombëtar për planifikimin dhe ndjekjen e këtyre rasteve, si dhe mospasja e një bazë ligjore dhe metodologjike të përditësuar për punën e shërbimit psiko-social, ka bërë që këto ndërhyrje të mos përfshihen si pjesë integrale e punës së përditshme të specialistëve por si një pjesë e punës në bazë nevojë dhe rastesh emergjente.

Dokumentet udhëzuese aktualisht në përdorim janë të kufizuara kryesisht në një udhëzues teknik të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, i cili nuk shoqërohet me mekanizma mbikëqyrjeje apo vlerësimi të zbatimit. Për më tepër, mungon një strukturë mbështetëse profesionale për supervizimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të këtyre specialistëve, çka ndikon në rritjen e pasigurisë profesionale dhe në qasjen pasive ndaj problematikave.

⁸ Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social, miratuar nga MAS me nr.2116/6, datë 27.07.2022, Vlerësimi individual, faqe 55

Për pasojë, ndërhyrjet psiko-sociale në shumicën e rasteve nuk zhvillohen në funksion të parandalimit dhe promovimit të mirëqenies së nxënësve, por si përgjigje ndaj rasteve që janë tashmë të evidentuara dhe shpesh të përshkallëzuara. Kjo e kufizon rolin transformues të shërbimit në sistemin arsimor dhe e orienton atë drejt një qasjeje që i ngjan më shumë menaxhimit të krizave, sesa ndërtimit të një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët dhe të rinjtë.


Shërbimi psiko-social përballet me sfida në përditshmëri.

Specialistët që ushtrojnë funksionin e psikologut ose punonjësit social në institucionet e arsimit parauniversitar kanë një rol të ndjeshëm, që kërkon ndërhyrje profesionale, etike dhe metodologjike të orientuar. Ata përballen çdo ditë me problematika të ndërlikuara si: dhuna brenda dhe jashtë mjedisit shkollor; fenomeni i bullizmit dhe i ngacmimeve të vazhdueshme; trauma të lidhura me humbje, përjetime të dhunshme apo situata familjare të vështira; çrregullime të sjelljes dhe vështirësi të shprehura në mënyrë të heshtur nga nxënësit.

Në këtë kontekst, nevoja për trajnime të rregullta dhe supervizim profesional të vazhdueshëm është jo vetëm e rekomanduar, por e domosdoshme për garantimin e cilësisë së shërbimit. Për këtë arsye është e nevojshme që këto specialistë të trajnohen vazhdimisht nga institucionet përkatëse, në bazë të nevojave dhe për të plotësuar më shumë panoramën e menaxhimit të rasteve. ASCAP ofron trajnime por në një nivel mbulimi jo të gjerë dhe në numër të paktë⁹.

Tabela dhe grafiku më poshtë paraqesin temat kryesore të trajnimeve të zhvilluara për specialistët e shërbimit psiko-social në arsimin parauniversitar gjatë viteve 2022–2024, së bashku me pjesëmarrjen dhe metodologjinë e ndjekur për secilin trajnim.

Grafiku nr. 8 Trajnimet e SHPS



Burimi ASCAP, përpunoi Grupi i Auditimit

Një ndër faktorët që ndikon negativisht në zbatimin e shërbimit psiko-social në shkolla është mungesa e bashkëpunimit të prindërve, e ndikuar nga perceptime të gabuara mbi rolin e psikologut në institucionin arsimor. Nga intervistat dhe takimet e zhvilluara gjatë auditimit në disa shkolla të ciklit parauniversitar u evidentua se, shumë prindër e lidhin ndërhyrjen e psikologut ose punonjësit social me probleme të rënda psikologjike dhe rrjedhimisht e refuzojnë përfshirjen në procesin e ndërhyrjes. Si procedurë prindërit në fillim të vitit shkollor duhet të firmosin një formular të vënë në dispozicion nga shkolla për të dhënë aprovimin mbi

⁹Përgjigje me email zyrtar nga ASCAP, data 25.06.2025

dakordësinë që fëmija të mund të marrë këshillim psiko-social, sipas nevojave ose rastit. Në veçanti, shumë prindër refuzojnë të nënshkruajnë formularin e miratimit (aprovimit). Gjendur në këtë situatë stafi i shërbimit psiko-social përballlet me problemin dhe nuk mund të ndërhyjë,¹⁰ përveç rasteve kur rreziku është emergjent dhe e justifikon ndërhyrjen pa vonesa. Në rastet e tjera megjithëse ndërhyrja është një kërkesë e domosdoshme për fillimin e planit individual të ndërhyrjes veprimtaria e tyre kufizohet.

Mungon supervizimi i strukturuar dhe efektiv për punonjësit e shërbimit psiko-social.

Mbikëqyrja dhe mbështetja profesionale e punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla është një komponent thelbësor për garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të ndërhyrjeve ndaj nxënësve. Përgjegjësia për këtë funksion dhe praktikës së organizimit institucional, i takon njësive të shërbimit psiko-social të ngritura pranë Zyrave Vendore Arsimore (ZVAP). Këto njësi kanë për detyrë të ofrojnë ndihmë teknike dhe metodologjike për specialistët në terren, të identifikojnë nevojat për zhvillim profesional dhe kapacitete në nivel shkolle, të sigurojnë monitorimin dhe orientimin e praktikës së përditshme të punonjësve psiko-socialë, si dhe të ndërmjetësojnë bashkëpunimin ndërinstitutional për rastet që kërkojnë ndihmë të specializuar jashtë sistemit arsimor¹¹. Megjithatë, nga vëzhgimet në terren dhe informacionet e mbledhura gjatë auditimit rezulton se, funksioni i supervizimit nuk realizohet në mënyrë të strukturuar dhe efektive, për disa arsye kryesore:

ZVAP-et shpesh funksionojnë me staf të reduktuar në sektorin e shërbimit psiko-social, ku një apo dy punonjës janë përgjegjës për një territor të gjerë shkollash dhe numër të madh specialistësh psiko-socialë¹². Urdhrit i Ministrisë nr. 313 datë 20.10.2020, i ndryshuar, detyron që për çdo 30 punonjës të psikologëve apo punonjësve socialë, caktohet supervizori përkatës. Në shumë raste i njëjti punonjës mbulon edhe funksionin e supervizorit, edhe detyra operative si psikolog apo punonjës social në një ose më shumë shkolla. Për shkak të ngarkesës administrative, prioritetet zhvendosen në detyra të tjera (raportime, statistika, proces-verbalë), duke lënë në plan të dytë mbështetjen profesionale të drejtpërdrejtë.

Koha e punës së tyre është e organizuar në mënyrë të alternuar, ku në ditë të caktuara të javës ata ushtrojnë detyrën si punonjës psiko - social në institucionet arsimore përkatëse dhe në ditë të tjera zhvillojnë detyrat përkatëse si drejtues njësie, apo supervizorë në nivelin vendor të administrimit arsimor. Kjo ndarje kohore bazohet në nevojat e terrenit dhe në përcaktimet e njësisë në funksion të mbulimit efektiv të të dyja roleve.

Referuar kuadrit ligjor dhe rregullator aktualisht në fuqi, nuk parashikohen përfitime financiare shtesë për profesionistët e shërbimit psiko - social që ushtrojnë njëkohësisht edhe funksionin e supervizorit apo drejtuesit të NJSHP.

Ata paguhet në të njëjtin nivel me punonjësit e tjerë të shërbimit psiko-social në shkolla, pa ndonjë kompensim shtesë për përgjegjësitë shtesë që burojnë nga ushtrimi i rolit të supervizorit. Kjo pavarësisht sfaktit që funksioni i tyre përfshin detyra shtesë si, koordinimi, ndjekja dhe monitorimi i punës së punonjësve të tjerë të shërbimit, raportimi dhe mbështetja profesionale në terren.

Në nivel DRAP-i situata e përfshirjes së supervizorëve si pjesë e shërbimit paraqitet si më poshtë:

¹⁰ Intervistat në terren 23.04.2025, Shkolla/Gjimnazi Bab Dudë Karbunara, Berat

¹¹ <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/Standardet-e-Pergjithshme-Profesionale-te-SHPS.pdf>

¹² Përgjigjet zyrtare me email nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar

Tabela nr. 5 Supervizorët e Shërbimit (Gjendja aktuale)

Nr.	Strukturat ZVAP ose DRAP	Nr. Supervizorësh	Nr. Supervizorësh që janë edhe pjesë e shërbimit
1	DRAP KORCE	5	5
2	DRAP FIER	3	3
3	DRAP LEZHE	5	5
4	DRAP TIRANE	11	11
5	DRAP DURRES	7	7

Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i Auditimit

Mungon një metodologji e standardizuar supervizimi

Aktualisht, nuk ekziston një udhëzim i dedikuar ose manual i miratuar nga MASR/ASCAP për mënyrën se si duhet të realizohet supervizimi profesional i specialistëve në shkolla. I vetmi dokument që trajton rolin dhe detyrat për supervizorin është vetëm udhëzuesi i SHPS që përdoret për të mbuluar të gjitha funksionet në lidhje me këtë shërbim. Për pasojë nuk ka një model të unifikuar mbikëqyrjeje, si p.sh. sesione reflektimi, vizita periodike në shkolla, raste të mbledhura për analizë kolegjiale, etj. Specialistët nuk kanë mundësi të diskutojnë sfida profesionale apo etike në një mjedis të mbrojtur profesional dhe të mbështetur nga kolegë apo drejtues teknikë. Mungon një sistem dokumentimi për supervizimin, që do të ndihmonte në matjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Në mungesë të kushteve dhe strukturës së nevojshme, supervizori nuk mund të përmbushë rolin e tij si, mentor/këshillues për orientimin metodologjik dhe etik të punës së specialistëve të shërbimit psiko-social, burim mbështetjeje për çështje të ndërlikuara që kërkojnë qasje të koordinuar, udhëheqës teknik për ngritjen e kapaciteteve dhe ndarjen e përvojës midis shkollave.

Kështu, funksioni i supervizorit mbetet kryesisht formal, i reduktuar në aktivitete raportuese dhe informuese dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e performancës së specialistëve në terren.

Mungesa e një sistemi funksional dhe të mirë organizuar të supervizimit profesional, përbën një boshllëk në sistemin e mbështetjes psiko-sociale në shkolla. Ky vakum cenon cilësinë e shërbimit, rrit ndjeshmërinë ndaj gabimeve profesionale dhe e lë specialistin të izoluar në praktikën e tij të përditshme, pa mundësinë për të reflektuar, ndarë dhe përmirësuar qasjen e tij. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për krijimin e strukturave të qarta mbështetëse, manualeve standarde për supervizim, dhe përforcimin e kapaciteteve njerëzore në nivel vendor.

-Dhuna në shkolla po rritet dhe arsimit parauniversitar ka nevojë për më shumë mbështetje¹³.

Të dhënat më të fundit nga raporti i ASCAP¹ për vitin shkollor 2022–2023 tregojnë një situatë shqetësuese për dhunën në shkollat tona. Janë regjistruar 2,750 raste dhune në sistemin parauniversitar, një shifër që nuk mund të injorohet. Në disa shkolla, kjo dhunë është bërë pjesë e përditshme – vetëm në një shkollë në Tiranë janë raportuar 90 raste gjatë vitit 2022 -2023.


Shpërndarja e rasteve të dhunës sipas DRAP-eve

Të dhënat e paraqitura më poshtë tregojnë shpërndarjen e rasteve të dhunës sipas drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar. Nga gjetjet e përfuara vihet re se DRAP-i me numrin më të lartë të rasteve të dhunës të raportuara/konstatuara është ai i Durrësit me 1637 raste që përbën

¹³ Raporti i identifikimit të parandalimit e raportimit të dhunës, bullizmit dhe forma të tjera në IAP;

edhe 59,5% të rasteve të dhunës në nivel kombëtar. DRAP-i me numrin më të ulët të rasteve të dhunës të deklaruara është ai i Fierit me 242 (8,8%) të tilla.¹⁴

Grafiku nr. 9



Burimi¹⁵, përpunoi Grupi i auditimit

Ajo që bie në sy është se, më shumë se gjysma e këtyre rasteve ndodhin në arsimin e mesëm, pikërisht në periudhën kur adoleshentët përballen me më shumë pasiguri, ndryshime emocionale dhe sociale. Shumica e rasteve përfshijnë bullizëm, dhunë verbale dhe psikologjike, forma të dhunës që mund të mos lënë shenja fizike, por lënë plagë të thella në vetëvlerësim dhe mirëqenie.

Një fakt tronditës është se në mbi 80% të rasteve, janë vetë nxënësit që ushtrojnë dhunë ndaj bashkëmoshatarëve të tyre. Ndërkohë, pjesa më e madhe e incidenteve ndodhin në vende si korridoret, oborri i shkollës, klasat pa mbikëqyrje apo jashtë mjediseve të shkollës. Kjo do të thotë që dhuna ndodh atje ku nuk ka një figurë mbështetëse që të ndërhyjë në kohë.

Çdo shkollë duhet të mbulohet nga një psikolog apo punonjës social. Ndërkohë shumë prej specialistëve të këtij shërbimi mbulojnë disa shkolla njëherësh, duke u shfaqur në secilin institucion vetëm disa ditë në javë. Kjo sjell mbingarkesë me punë administrative dhe kohë të pamjaftueshme për të ndjekur nga afër rastet, për të zhvilluar punë parandaluese me klasat apo për të ndërtuar besim me nxënësit.

Situata e shërbimit psiko-social në arsimin parauniversitar nuk analizohet dhe nuk ka një mënyrë të përcaktuar raportimi.

Edhe pse Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), në bashkëpunim me institucionet arsimore vendore, mbledh periodikisht të dhëna mbi numrin e fëmijëve që marrin këshillim dhe ndërhyrje nga shërbimi psiko-social në shkolla, këto të dhëna mbeten të kufizuara në aspektin informues dhe nuk përkthehen në një analizë të strukturuar për të kuptuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar situatën psiko-sociale të nxënësve në rang vendi.

Në mungesë të treguesve cilësorë dhe tematikë, të dhëna si “numri i këshillimeve” ose “numri i ndërhyrjeve” nuk japin informacion për natyrën e problematikave që përjetojnë fëmijët, siç janë simptomat e depresionit, ankthit, bullizmit, dhunës në familje, abuzimit, apo braktisjes shkollore. Për më tepër, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk disponon një raport kombëtar vjetor apo një sistem të monitorimit dhe analizës tematike që të evidentojë tipologjinë dhe përhapjen e vështirësive psiko-sociale me të cilat përballen fëmijët në sistemin parauniversitar.

¹⁴ Raporti i identifikimit të parandalimit e raportimit të dhunës, bullizmit dhe forma të tjera në IAP

¹⁵ Raporti i identifikimit të parandalimit e raportimit të dhunës, bullizmit dhe forma të tjera në IAP

Edhe raportet sporadike, si ai i realizuar nga ASCAP mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkolla, janë hartuar në bazë të pyetësorëve të veçantë dhe jo mbi bazën e sistemit të rregullt të mbledhjes së të dhënave nga vetë shërbimi psiko-social. Kjo tregon se, ndonëse në nivel funksional shërbimi psiko-social ofron ndërhyrje dhe këshillime, ai nuk prodhon një panoramë të integruar dhe të përdorshme për politika publike dhe nuk kontribuon në mënyrë sistematike në përmirësimin e qasjes institucionale ndaj mirëqenies së fëmijëve.

Një nga boshllëqet më të dukshme në funksionimin e shërbimit psiko-social në arsimin parauniversitar lidhet me mungesën e indikatorëve të qartë, të standardizuar dhe të matshëm për vlerësimin e cilësisë së ndërhyrjeve dhe ndikimit të tyre në mjedisin shkollor dhe mirëqenien e nxënësve. Gjatë procesit të auditimit grupi i auditimit konstatoi se, ndonëse shërbimi psiko-social është funksional në shumicën e shkollave, vlerësimi i performancës së tij mbetet i kufizuar në tregues sasiore, si numri i këshillimeve individuale, grupore, apo numri i aktiviteteve të ndërjegjësimit. Këto të dhëna, megjithëse të dobishme për pasqyrimin e aktivitetit të specialistëve, nuk ofrojnë një pamje të qartë mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe cilësinë e mbështetjes së ofruar.

Në praktikë, mungojnë mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm të vlerësimit të performancës, të cilët të jenë të lidhur me objektiva të qarta dhe të matshme të shërbimit. Nuk ekzistojnë indikatorë që të masin nëse: ndërhyrjet psiko-sociale kontribuojnë në uljen e braktisjes shkollore ose përmirësimin e frekuentimit të nxënësve; këshillimet kanë ndihmuar në zvogëlimin e rasteve të bullizmit, konflikteve apo dhunës në shkollë; mbështetja psiko-sociale ka pasur ndikim pozitiv në përfshirjen sociale dhe zhvillimin emocional të nxënësve; prania e specialistëve ka rritur ndjenjën e sigurisë dhe mirëqenies në komunitetin shkollor. Në mungesë të këtyre treguesve, autoritetet arsimore, përfshirë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nuk kanë një instrument objektiv dhe të qëndrueshëm për të monitoruar ecurinë e shërbimit dhe për të marrë vendime të bazuara në evidencë në lidhje me përmirësimin e tij. Gjithashtu, vetë specialistët e fushës nuk kanë referenca të qarta që t'i ndihmojnë të matin progresin apo të reflektojnë mbi efektivitetin e praktikës së tyre profesionale.

Kjo mungesë reflekton një problem më të gjerë në planifikimin dhe menaxhimin e shërbimit psiko-social si pjesë integrale e sistemit arsimor. Kuadri i qartë i vlerësimit të cilësisë, do të duhej të ishte pjesë e vetë strukturës së monitorimit institucional. Edhe aty ku raportime periodike ndodhin, ato mbeten kryesisht për qëllime statistikore dhe nuk shoqërohen me analiza përmbajtësore që të nxjerrin në pah tipologjinë e problematikave, grupet më të prekura apo trendet e përhapjes së vështirësive psiko-sociale.

Gjithashtu, mungojnë instrumente të unifikuara matjeje, si p.sh. grupe treguesish të përcaktuar nga MAS apo ASCAP, që të përdoren nga të gjithë specialistët në mënyrë të standardizuar për matjen e përmirësimeve individuale apo të klimës së përgjithshme në shkollë. Kjo ndikon edhe në pamundësinë për të krahasuar shkolla apo rajone të ndryshme dhe për të zhvilluar politika të diferencuara në bazë të nevojave reale në terren. Për rrjedhojë, vendimmarrja në nivel politikash për këtë shërbim mbështetet më tepër në perceptime të përgjithshme apo në raporte të pjesshme, sesa në një analizë të plotë, të bazuar në të dhëna të matshme dhe të krahasueshme. Kjo ndikon negativisht në ndarjen e burimeve, përmirësimin e standardeve profesionale dhe fuqizimin e rolit të këtij shërbimi si instrument thelbësor në garantimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për çdo fëmijë. Nga ana tjetër nuk ka gjurmë të bashkëveprimit me katedrat universitare, për fushat e psikologjisë dhe punës sociale të cilët formojnë brezat e rinj të psikologëve dhe punonjësve socialë. Nuk ka plane për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve në shkollat e arsimit parauniversitar të cilat mund të jenë gjithashtu një nxitje për orientimin e tyre drejt këtyre profesioneve.

Roli i psikologut dhe punonjësit social në shërbimin psiko – social në shkolla nuk është i barasvlershëm.

Shërbimi psiko-social në shkolla realizohet nga psikologët ose punonjësit socialë, të cilët bashkëpunojnë për të mbështetur zhvillimin emocional, social dhe akademik të nxënësve. Është thelbësore të kuptohet se, ndonëse këto dy figura ofrojnë mbështetje për komunitetin shkollor, ato kanë kompetenca dhe detyra të ndryshme.

Psikologët janë të pajisur me aftësinë për të kryer vlerësime të thelluara të zhvillimit emocional dhe mendor të nxënësve. Ata administrojnë dhe interpretojnë teste psikologjike, kryejnë komisione për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe ofrojnë këshillim individual dhe në grup, duke synuar rritjen personale, psiko - edukimin dhe menaxhimin e emocioneve.

Ndërkohë, punonjësit socialë përqendrohen kryesisht te aspektet sociale të nxënësve. Ata kryejnë vlerësimin social, adresojnë çështje të tilla si varfëria, dhuna në familje, braktisja shkollore dhe problemet e nxënësve me nevoja speciale, kryejnë vizita në familje dhe bashkëpunojnë me institucione të tjera për mbrojtjen e fëmijëve. Këto veprimtari synojnë sigurimin e një mbështetje të plotë sociale për të gjithë aktorët e komunitetit shkollor.

Bashkëpunimi i këtyre dy roleve, siç përcaktohet edhe në “Manualin e punës për punonjësit e njësisë së shërbimit psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar” (2020) dhe “Udhëzuesit të Shërbimit Psiko-Social” (2022), përfshin disa detyra të përbashkëta dhe konkretisht:

- Vlerësimi i nevojave të nxënësve: Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e tyre;
- Ofrimi i këshillimit dhe mbështetjes: Individualisht dhe në grup për nxënësit, mësuesit dhe prindërit;
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere: Të cilat synojnë rritjen e ndërgjegjes rreth çështjeve emocionale, psikologjike dhe sociale;
- Referimi i rasteve të caktuara: Për mbrojtjen e fëmijëve dhe për veprim në institucionet përkatëse;
- Përfshirjen në komisione specifike Për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke kontribuar në vlerësimin dhe planifikimin e mbështetjes së nevojshme.

Megjithatë, është thelbësore të pranohet se psikologët dhe punonjësit socialë janë profesionistë të rregulluar me dallime të rëndësishme në këndvështrimin dhe funksionin e tyre. Psikologët kanë kompetencën për të kryer vlerësime psikologjike dhe për të administruar teste, ndërsa punonjësit socialë përqendrohen kryesisht në vlerësimet sociale dhe vizitat në familje. Këshillimi i ofruar nga secili i përmbush natyrën specifike të profesionit të tyre: ndërkohë që psikologu synon zhvillimin personal, psiko-edukimin dhe menaxhimin e emocioneve, punonjësi social ofron mbështetje që kanë bazë kryesisht sociale dhe integruese.

Nisur nga sa më sipër, duhet theksuar se Urdhri nr. 313, nuk jep orientim të qartë për DRAP – et dhe ZVAP – et sa i takon përzgjedhjes së psikologut apo punonjësit social për t`u rekrutuar në shërbim. Në praktikë përzgjedhja midis njërës figurë apo tjetrës, mbetet në diskrecionin e DRAP – it, pa u bazuar në një vlerësim të mirëfilltë të nevojave të shërbimeve specifike sipas karakteristikave të ZVAP – ve dhe mundësive për të plotësuar shërbimin e figurat profesionale të duhura.

Bazuar në panoramën aktuale të shërbimit psiko-social, u analizuan edhe praktikat e vendeve të rajonit që kanë ndërtuar modele më funksionale të shërbimeve psiko-sociale në shkolla. Mali i Zi, për shembull, ofron një model organizimi më të qartë dhe efektiv: specialistët janë të përfshirë në planifikimin strategjik të shkollave, ndërhyrjet nuk janë vetëm reaktive, por synojnë edhe parandalimin përmes edukimit psiko-social dhe punës me komunitetin. Po ashtu, ekzistojnë protokolle të detajuara, rrjete bashkëpunimi ndërinstitutional dhe një sistem raportimi dhe supervizimi të rregullt, që ndihmon në standardizimin dhe përmirësimin e

vazhdueshëm të shërbimit. Prindërit janë të përfshirë në mënyrë më aktive në proces, përmes fushatave të informimit dhe përmes një klime më pak stigmatizuese ndaj rolit të psikologut. Për të ofruar një pasqyrë mbi mënyrën se si organizohen shërbimet psiko-sociale në një kontekst tjetër kombëtar, kjo pjesë përshkruan elemente të përzgjedhura të sistemit në Mal të Zi - një vend me karakteristika të ngjashme rajonale dhe demografike.

Shembull i praktikës ndërkombëtare: Shërbimet Psiko-sociale të Arsimit Parauniversitar në Mal të Zi

Në Mal të Zi, shërbimet psiko-sociale në arsimin parauniversitar janë pjesë e një kuadri më të gjerë kombëtar të mbështetur nga legjislati¹⁶ për arsimin gjithëpërfshirës dhe mbrojtjen e fëmijëve. Çdo shkollë kërkohet të ketë të paktën një psikolog ose pedagog të pranishëm çdo ditë. Ministria e Arsimit ka përcaktuar role funksionale të qarta për këta profesionistë, të cilat përfshijnë¹⁷:

- mbështetjen e zhvillimit emocional dhe social të nxënësve,
- kontributin në proceset pedagogjike dhe udhëzimin profesional,
- bashkëpunimin me familjet, dhe
- promovimin e një klime shkollore pozitive dhe gjithëpërfshirëse.

Psikologët në shkolla zhvillojnë rregullisht aktivitete parandaluese, si punëtori mbi rregullimin emocional, komunikimin paqësor, parandalimin e bullizmit dhe trajnimin e aftësive sociale në grup.

Sistemi gjithashtu përfshin mekanizma formalë për bashkëpunim ndër-institucional, ku shkollat punojnë me qendrat për punë sociale, komunat dhe organizatat e jashtme mbështetëse. Në raste komplekse, psikologët marrin pjesë në ekipe shumë disiplinore që koordinojnë ndjekjen ndër sektoriale.

Zhvillimi profesional dhe mbikëqyrja janë të integruara në sistem. Psikologët dhe mësuesit marrin pjesë në trajnime vjetore të detyrueshme dhe kanë akses në mbikëqyrje profesionale të rregullt. Për më tepër, janë përdorur fushata për ndërgjegjësimin e prindërve me qëllim ndërtimin e mirëkuptimit dhe mbështetjes për rolin e psikologëve shkollore.

Për të monitoruar zbatimin e shërbimeve, Mali i Zi ka futur tregues të performancës për shërbimet psiko-sociale. Këta tregues përdoren për të vlerësuar aspekte të ofrimit dhe kontribuojnë në planifikimin dhe llogaridhënien në arsim.

Ky shembull ilustron një mënyrë të strukturimit të shërbimeve psiko-sociale të bazuara në shkollë dhe mund të ofrojë input të vlefshëm për diskutimet e politikave në kontekste të tjera¹⁸.

Rruga drejt përmirësimit kalon përmes garantimit të një përfshirje me të gjerë të specialistëve në shkolla, rritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, forcimit të rolit të njësive vendore të SHPS(Shërbimit Psiko-Social), përmirësimit të ndërgjegjësimin të komunitetit dhe krijimit të një sistemi të qartë të vlerësimit të performancës dhe bashkëpunimit ndërsektorial.

¹⁶ Kushtetuta e Malit të Zi (Neni 75)

¹⁷ Ligji nr. 27/2013 (dhe ndryshimet e mëvonshme deri në 2021) përcakton bazën ligjore për shërbimet sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë shërbimet psikosociale dhe ato edukative në kontekstin institucional dhe komunitar

¹⁸https://www.unicef.org/montenegro/sites/unicef.org.montenegro/files/2019_05/MONTENEGRO_INCLUSIVE_EDUCATION_STRATEGY_1a-1b-REVISE-6%20eng.pdf

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit 2015-2020 në Malin e Zi

6- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, punonjësit e shërbimit psiko-social që shërbejnë në shkolla nuk përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në trajnime. Sipas të dhënave zyrtare nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), për periudhën 2022-2024 janë realizuar gjithsej 7 trajnime në rang vendi. Kjo agjenci nuk disponon një strukturë të dedikuar për zhvillimin e trajnimeve e cila garanton zhvillimin e vazhdueshëm profesional të psikologëve dhe punonjësve psiko-socialë në arsimin parauniversitar.

Mungesa e përditësimit profesional mund të ndikojë në cilësinë e ndërhyrjeve, veçanërisht në rastet e ndërlikuara. Nga ana tjetër nuk ka bashkëveprim me katedrat universitare, për fushat e psikologjisë dhe punës sociale, lidhur me studimet e kryera në këto fusha, analizimet e të dhënave etj.

7- Gjetje nga auditimi: Ndërhyrjet e shërbimit psiko-social në shkolla janë kryesisht të përqendruara në menaxhimin e situatave pasi problematikat janë shfaqur, pra në fazën pasuese të vështirësive dhe jo në fazën parandaluese. Mungesa e kohës së mjaftueshme, burimeve dhe strukturave të planifikuara për ndërhyrje të hershme pengon zhvillimin e një pune të qëndrueshme parandaluese me nxënësit.

8- Gjetje nga auditimi: Nga vizitat e kryera në 12 shkolla, pjesë e 4 Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Lezhë, Fier dhe Korçë, rezultoi se pothuajse në të gjitha shkollat, prindërit kanë përgjithësisht refuzojnë të firmosin formularin e miratimit për përfshirjen e fëmijëve të tyre nga shërbimi psiko-social, siç parashikohet në praktikat e punës së këtij shërbimi. Sipas të dhënave nga punonjësit e shërbimit psiko-social dhe specialistëve të DRAP, ky refuzim lidhet kryesisht me perceptime stigmatizuese ndaj rolit të psikologut në institucionin arsimor, i cili shpeshherë shihet si një figurë që ndërhyt vetëm në situata të rënda problematike, duke penguar kështu ofrimin e mbështetjes së nevojshme për fëmijët në kohë dhe në mënyrë të strukturuar.

9- Gjetje nga auditimi: Në sistemin arsimor parauniversitar mungojnë protokollat standarde të nivelit kombëtar për identifikimin, referimin, ndërhyrjen dhe ndjekjen e rasteve nga specialistët psiko-socialë. Aktualisht, ndërhyrja bëhet bazuar vetëm nga udhëzuesi i shërbimit psiko-social si dokument i vetëm orientues për të rregulluar këtë shërbim. Mungesa e protokolleve standarde të unifikuara ndikon në cilësinë dhe funksionimin e shërbimit psiko-social.

10- Gjetje nga auditimi: Aktualisht, në sistemin parauniversitar nuk ekziston një sistem kombëtar i standardizuar dhe i unifikuar për matjen e performancës dhe ndikimit të shërbimit psiko-social në shkolla. Mungesa e indikatorëve ndikon në vlerësimin objektiv të rezultateve të punës së specialistëve dhe efektit të ndërhyrjeve psiko-sociale, mbledhjen dhe analizimin e strukturuar të të dhënave lidhur me cilësinë e shërbimit.

11- Gjetje nga auditimi: Roli i psikologut dhe punonjësit social në shërbimin psiko-social shkollor nuk po trajtohet në mënyrë të diferencuar e të përshtatur me nevojat konkrete të institucioneve arsimore, për shkak të mungesës së udhëzimeve të qarta në bazën rregullatore në fuqi. Edhe pse këto dy figura kanë funksione dhe kompetenca të dallueshme, psikologu fokusohet në vlerësimin dhe zhvillimin emocional e mendor të nxënësve, ndërsa punonjësi social në ndërhyrjet sociale dhe bashkëpunimin me familjen dhe institucionet.

Përzgjedhja midis tyre bëhet në mënyrë të njëtrajtshme dhe pa një analizë paraprake të nevojave specifike të zonës apo shkollës. Kjo situatë, vjen si pasojë e mungesës së një mekanizmi të strukturuar për vlerësimin e profilit më të përshtatshëm për çdo institucion dhe ka sjellë

vendosje jo optimale të stafit dhe për rrjedhojë, ulje të efektivitetit të shërbimit psiko-social në mbështetjen reale të nxënësve të arsimit parauniversitar publik.

12- Gjetje nga auditimi: Punonjësit e shërbimit psiko-social që ushtrojnë funksione supervizuese ose drejtuese në nivel vendor kryejnë njëkohësisht edhe funksionin e psikologut apo punonjësit social në institucionin arsimor ku janë të emëruar. Ky organizim me funksione të dyfishta zhvillohet në mënyrë të alternuar gjatë javës, pa një ndarje të qartë kohore dhe pa një strukturë të dedikuar që të sigurojë ushtrimin e plotë dhe efektiv të dy roleve. Për më tepër, kuadri rregullator dhe skema e trajtimit financiar në fuqi nuk parashikojnë përfitime apo kompensim shtesë për punonjësit që ushtrojnë rolin e supervizorit apo drejtuesit të njësisë, pavarësisht përgjegjësi shtesë që ky funksion përfshin.

2. Konkluzioni: Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare nuk arrin të identifikojë dhe adresojë problemet e vërteta të nxënësve në shkolla. Ai një qasje kryesisht reaguese dhe jo parandaluese ndaj nevojave të nxënësve. Mungon supervizimi i strukturuar dhe i uniformizuar i shërbimit dhe një analizë kombëtare e situatës psiko-sociale në shkolla. Ka mungesa në trajnimet e vazhdueshme për të unifikuar për mbështetjen profesionale të stafit. Evidentohen gjithashtu nevoja për përmirësime organizative dhe metodologjike, në ofrimin efektiv dhe gjithëpërfshirës të këtij shërbimi.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Agjencinë Kombëtare për Arsimin, Parauniversitar (AKAP):

-Të krijojë dhe zbatojë një program kombëtar të detyrueshëm për trajnime vjetore dhe supervizim profesional për psikologët dhe punonjësit socialë në shkolla, me fokus në aftësitë praktike dhe menaxhimin e rasteve të ndërlikuara;

-të thellojë bashkëpunimin me katedrat universitare si një vlerë e shtuar në studimin e fenomeneve në arsim, analizimin e të dhënave, zhvillimin e praktikave mësimore për studentët, si dhe për të qenë një nxitës në formimin e profesionistëve të rinj.

Brenda datës 30.06.2026 dhe në vijimësi

7.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit të marrë masa për promovimin e një qasje parandaluese në shërbimin psiko-social, përmes përcaktimit të aktiviteteve të rregullta edukative për forcimin e mirëqenies mendore që në ciklin fillor të arsimit parauniversitar.

Në vijimësi

8.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Agjencinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar (AKAP), të marrë masa për përditësimin dhe unifikimin e procesit të organizimit të fushatave të rregullta ndërgjegjësuere në shkolla, të fokusuara tek prindërit dhe komuniteti, për të promovuar rolin mbështetës të specialistëve psiko-socialë dhe për të nxitur bashkëpunimin me ta.

Në vijimësi

9.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, të hartojë dhe miratojë protokolle standarde për identifikimin e hershëm, referimin, ndërhyrjen dhe monitorimin e rasteve të adresuara nga shërbimi psiko-social në shkolla. Këto protokolle të jenë të detyrueshme për zbatim në të gjitha institucionet arsimore dhe të shoqërohen me trajnime për specialistët, si dhe me udhëzues praktikë, për të siguruar ndërhyrje të harmonizuara, efektive dhe të krahasueshme në shkallë kombëtare.

Brenda datës 30.06.2026

10.1 Rekomandimi: Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të zhvillojë dhe zbatojë një sistem kombëtar të vlerësimit të performancës së shërbimit psiko-social në shkolla, i cili të përfshijë:

- Indikatorë specifikë për matjen e ndikimit në përfshirjen sociale të nxënësve, parandalimin e braktisjes dhe përmirësimin e mirëqenies emocionale;
- mbledhjen e rregullt të të dhënave dhe përdorimin e tyre për përmirësim të shërbimeve dhe planifikim politikash;
- të hartojnë paketën kombëtare të trajnimit mbi përdorimin e indikatorëve të performancës dhe ndikimit të shërbimit psiko-social në shkolla, duke përfshirë: metodologjinë e mbledhjes së të dhënave, interpretimin e rezultateve, përdorimin e tyre për përmirësim të praktikës profesionale.

Brenda datës 30.06.2026

11.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit të hartojë udhëzime të qarta për Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimin Parauniversitar mbi përzgjedhjen ndërmjet psikologut dhe punonjësit social, duke u bazuar në nevojat specifike të shkollave dhe karakteristikat e komunitetit arsimor që ato shërbejnë.

Brenda datës 30.06.2026

12.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit të rishikojë organizimin e pozicioneve drejtuese dhe supervizuese të shërbimit psiko-social dhe skemën e angazhimit/shpërblimit për punonjësit e shërbimit psiko-social që ushtrojnë funksione të dyfishta.

Brenda datës 30.06.2026

5.1.3 Pyetje e auditimit: A janë politikat dhe veprimtaritë e institucioneve në mbështetje të mirëfunksionimit të shërbimit psiko-social?

Mangësitë kryesore të evidentuara

- Korniza rregullatore që rregullon shërbimin psiko-social krijon paqartësi dhe në disa raste paraqitet kontradiktore;
- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit psiko-social në mënyrë të njëanshme nga MAS, pa bashkëveprimin me ministrinë e tjera të ndërlidhura, e bën shërbimin të cenueshëm nga ana strukturore dhe funksionale;
- Ndryshimet në shërbimin psiko-social nuk mbështeten në analiza të lidhur me treguesit e profesionistëve në nivel kombëtar;
- Ka shumë strategji që synojnë të njëjtat çështje, me mjete të ndryshme, por nuk ka asnjë strategji të dedikuar vetëm për shërbimin psiko-sociale;
- Institucionet e arsimit parauniversitar mbledhin të dhëna rreth çështjeve psiko-sociale, por ministrinë nuk i përdorin ato në mënyrë sistematike dhe nuk i ndajnë me njëra-tjetrën.


Institucionet politikbërëse sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

“Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti”. “Kushdo ka të drejtën për arsim”. “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm, një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”. Këto janë disa parime të përgjithshme që paraqiten në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si akti themeltar i shtetit.

Shërbimi psiko-social në shërbimin arsimor parauniversitar ndërlidh njëkohësisht disa ministri sipas fushave të tyre të përgjegjësisë shtetërore. Këtu përfshihen, fushat e përgjegjësisë që lidhen me mbrojtjen, përkujdesjen shëndetësore, sociale, por edhe shërbimin arsimor për

fëmijët. Fushat e përgjegjëse shtetërore në vend kanë pësuar ndryshime në periudha të ndryshme duke i'u atashuar ministrive të ndryshme ekzistuese apo dhe atyre të rikrijuara rishtaz në bazë të politikave të ndërmarra nga ekzekutivi. Aktualisht shërbimi psiko-social ndërthur tre ministri dhe konkretisht, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Figura nr. 6 Shërbimi psiko-social dhe ministrinë e ndërlidhura në të.



Punoi: Grupi i Auditimit

Korniza rregullatore që rregullon shërbimin psiko-social evidenton paqartësi dhe në disa raste paraqitet kontradiktore.

-Sipas Urdhrit nr. 313 kontrata e punës së psikologut/punonjësit lidhet me drejtuesin e institucionit arsimor ndërsa zgjidhja e saj bëhet nga titullari i DRAP-it. Kjo pas propozimit me shkrim nga drejtuesi i IAP, ose në raportet e inspektimit në të cilët rekomandohet largimi nga detyra. Kjo mënyrë veprimi bie ndesh edhe me përcaktimet e Kodit të Punës i cili trajton termin punëdhënës lidhur me marrëdhënien e punës që në rastin konkret është drejtuesi i IAP. Gjithashtu, përzgjedhja e psikologëve/punonjësve social bëhet në nivel DRAP-I, mbi bazën e një procesi manual, çka e cenon transparencën, problematikë kjo e ngritur edhe nga DPAP në muajin Korrik 2023.

Ndërkohë, përzgjedhja e supervisorit nuk bazohet në garë por ai përzgjidhet nga drejtuesi i Njesisë së Shërbimit Psiko-Social. Më pas miratimi bëhet nga titullari i DRAP. Detyrat dhe mënyra e raportimit të supervisorëve të psikologëve dhe atyre të punonjësve socialë në urdhër paraqiten me një paragraf të përgjithshëm, ndërkohë ato nuk përcaktohen as në rregulloren e brendshme të funksionimit të IAP-ve.

Figura e psikologut në shkollë trajtohet njëllë me atë të punonjësit social dhe nuk ka një rregullim të qartë se kur duhet përfshirë njëri profesionist apo tjetri. Kjo ndarje është vendosur rast pas rasti nga institucionet vendore të arsimit parauniversitar në mungesë të një rregullimi të qartë dhe shterues.

Ndryshimet¹⁹ e ndodhura gjatë vitit 2023 për të drejtën e ushtrimit të profesionit vetëm nga psikologët e licencuar në fushën e edukimit profileve janë iniciuar me kërkesë të Urdhrit të

¹⁹ Urdhri i Ministrisë nr. 414 datë 26.07.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrit nr. 313 datë 20.10.2020”;

Psikologut²⁰. Ky i fundit i ka parashtruar institucioneve që marrin pjesë në të ku përfshihet edhe MAS, orientime të cilat duhet të konsiderohen për rekrutimet që realizohen për psikologët dhe profilet përkatëse. Më pas kjo shkresë nga MAS është përcjellë në AKAP (ish DPAP). Kjo e fundit nga ana e saj ka dalë me disa propozime konkrete për ndryshimin e Urdhrit nr. 313, disa prej të cilave janë miratuar më pas.

Ndërkohë që DRAP-eve sipas Urdhrit nr.313 pas dështimit të procedurave për mospjesëmarrje të personave të licencuar u lind e drejta dhe ka vijuar me rekrutimet e psikologëve dhe punonjësve socialë me kontrata me afat deri në përfundim të vitit shkollor të kandidatëve që kanë kryer të paktën ciklin e parë të studimeve, pra pa përfunduar ciklin e dytë të studimeve, praktikën profesionale dhe pa licencën përkatëse. Në këto raste urdhri bie ndesh edhe me ligjin organik që rregullon profesionin. Pra në fakt ndryshimi i kryer nuk ka sjellë profilizim dhe eksperiencë të thelluar por ka prodhuar kufizim në pranimin e profesionistëve.

-Nga ana tjetër, Rregullorja e Brendshme²¹ për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në vend, e miratuar në vitin 2020, trajton funksionimin e shërbimit psiko-social që jepet pranë IAP-ve. Konstatohet se ky dokument i miratuar po me urdhër ministri, nuk shkon në të njëjtën linjë me Urdhrin nr. 313 po të vitit 2020 sa i përket ngritjes së Njësive të Shërbimit Psiko - Social. Sipas rregullores ngritja e shërbimit organizohet në nivel ZVA ndërkohë që sipas urdhrit ky shërbim funksionon në bazë DRAP-i.

Detyrat e drejtuesit të njësisë në rregullore janë gjithashtu të përgjithshme dhe të pa përditësuara me ndryshimet strukturore, ndërkohë që detyrat e tij vendosen nga secili DRAP dhe nuk janë të standardizuara. Nga ana tjetër drejtuesi i NJSHP dhe supervisorët kryejnë veprimtari edhe si psikolog ose punonjës social sipas rastit ndërkohë që kanë deri në 250 psikolog në varësi si në rastin e ish DRAP-Durrës.

Në dy aktet rregullative të cituara më sipër nuk ka parashikime për zëvendësimin, pezullimin apo largimin e tyre nga puna, çka nuk garanton këta drejtues në vijueshmërinë e detyrës së tyre. Kjo mënyrë paraqet kontradiktë pasi këta punonjës janë drejtues dhe punonjës njëkohësisht brenda juridiksionit të tyre, si dhe janë të ekspozuar ndaj veprimeve të padrejta/arbitrare të mundshme.

Ngritja dhe funksionimi i shërbimit psiko-social në mënyrë të njëanshme nga MAS, pa bashkëveprimin me ministrinë e tjera të ndërlidhura, e bën shërbimin të cenueshëm nga ana strukturore dhe funksionale.

Shërbimi psiko-social prej krijimit të tij deri sot është rregulluar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Ndryshimet në organizimin dhe funksionimin bëhen direkt nga MAS pas propozimeve apo iniciativave nga ana e institucioneve të varësisë. Ndërkohë fusha e psikologjisë dhe ajo e mbështetjes sociale për fëmijët ndërthuret brenda fushës së përgjegjësisë së disa ministrive. Përfshirja e ministrive si institucione politikbërëse, të cilat mbulojnë brenda fushës së përgjegjësisë së tyre, shëndetin mendor, mirëqenien sociale si dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, do të garantonte vendimmarrje më të plota. Gjithashtu do të përcaktonte mënyrën e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes tyre në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e këtij shërbimi.

Nëse do të krahasojmë mënyrën e organizimit të shërbimit psiko-social me shërbimin e sigurisë në shkollë, do të shohim se, krijimi dhe funksionimi i këtij të fundit rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave²² ndryshe nga shërbimi psiko-social. Psikologë, punonjës socialë, punonjësit e sigurisë janë të emërtuar punonjës arsimorë. Të tre shërbimet bashkëveprojnë së bashku brenda institucioneve arsimore. Ndërkohë organizimi dhe funksionimi bazohet në

²⁰ Shkresa e UP nr. 378 Prot date 27.06.2023

²¹ Rregullorja e Brendshme miratuar me Urdhrin e Ministrisë nr. 31, datë 28.01.2020;

²² VKM nr. 600 datë 09.10.2018, "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriteve për oficerët e sigurisë", i ndryshuar;

nivele të ndryshëm aktesh ligjor. Shërbimi psiko-social në nivel Urdhri Ministri ndërsa shërbimi i sigurisë në shkolla në nivel Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Një nivel më i lartë vendimmarrje dhe përfshirja e institucioneve përgjegjëse, do të shërbente më tepër në drejtim të ndërmarrjes së politikave gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara mes aktorëve në proces për këtë shërbim, të cilat janë të munguara aktualisht.


Ndryshimet në shërbimin psiko-social nuk mbështeten në analiza të lidhur me treguesit e profesionistëve në nivel kombëtar.

Sipas të dhënave të AKAP, numri i psikologëve/punonjësve socialë në shkolla për vitin shkollor 2024-2025 pa licencë të ushtrimit të profesionit është 144 ose rreth 28% e numrit gjithsej. Për të konkurruar për një vend pune si psikolog apo punonjës social në shkollat e arsimit parauniversitar fillimisht duhet të kesh përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të dytë ose ekuivalente në fushën e psikologjisë apo punës sociale, të zhvillosh praktikën profesionale dhe më pas të licencohesh nga urdhrat profesionalë përkatës. Për të përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave” i cili e pajis të diplomuarin me njohuri të thelluara teorike , si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, sipas ligjit të arsimit të lartë me kohëzgjatje normale duhen dy vite akademike. Për studimet “Master profesional” kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.

Referuar ligjeve organike të Urdhrit të Psikologut²³ dhe Urdhrit të Punonjësit Social²⁴, asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e psikologut dhe punonjësit social në sistemin publik apo privat, pa qenë anëtar i Urdhrit dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.

-Sipas të dhënave të MAS trendi i studentëve të cilët kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve dhe mund t'i drejtohen praktikës profesionale është jo stabil dhe paraqitet në rënie. Ndërkohë, psikologët dhe punonjësit socialë janë gjithnjë e më tepër prezentë në institucionet publike dhe private, referuar politikave të synuara për t'u përmbushur, sa i përket kujdesit shoqëror dhe shëndetësor të popullatës.

Grafiku nr. 10 Trendi i diplomimeve për vitet 2020-2024



Burimi: MAS, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

²³ Ligji nr. 40/2016: “Për Urdhrin e Psikologut në Shqipëri” neni 7 pika 1 i tij;

²⁴ Ligji nr. 163/2014: “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Shqipëri” neni 8 pika 1 e tij;

Me ndryshimet në kuadrin rregullator²⁵, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në Korrik 2023, janë shtuar kriteret e reja kufizuese për ushtrimin e profesionit të psikologut. Sipas këtyre ndryshimeve, për ushtrimin e profesionit të psikologut në sistemin arsimor parauniversitar duhet të disponosh të dy ciklet e diplomimit dhe pas vitit 2019, licencë nga Urdhri i Psikologut në fushën e psikologjisë së edukimit. Këto ndryshime nuk rezultojnë të jenë mbështetur në analiza të të dhënave numerike apo të jenë krahasuar me nevojat në vend për këtë profesion. Kjo për të parë dinamikën e shërbimit psiko-social dhe ndërmarrë politika objektive dhe të mbështetura në situatën faktike. Në pesë vitet e fundit akademike rreth 20% e studentëve të diplomuar në psikologji kanë ndjekur këtë fushë edukimi. Ndërkohë në total vihet re ulje e numrit të diplomimeve fushën e psikologjisë.

Tabela nr. 6 Diplomime të ciklit të dytë në psikologji nga universitetet në vend.

Diplomime cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave/Profesional	Viti akademik				
	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024
Fusha Psikologji Edukimi	69	81	110	67	67
Fusha Psikologjie të tjera	334	276	292	262	256
Gjithsej	403	357	402	329	323

Burimi: MAS, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

-Profesioni i psikologut dhe punonjësit social prej vitit 2014 janë përcaktuar si profesione të rregulluara. Kjo pas ndryshimeve ligjore të ndodhura²⁶ ku listës së mëparshme i janë shtuar dy profesione të reja. Në vijim i është hapur rrugë krijimit të dy urdhrave profesionalë profesionit përkatësisht Urdhri i Punonjësit Social sipas ligjit nr. 163/2014 dhe Urdhri i Psikologut sipas ligjit nr. 40/2016. Të dy urdhrat janë ente publike jobuxhetore të pavarura, të cilat përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e përbashkëta të anëtarëve të tyre dhe përcaktojnë kriteret për ushtrimin e profesionit, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e profesioneve, në mbrojtje të interesit publik. Organet drejtuese të tyre kanë pjesëmarrje të përcaktuar për përfaqësues të ministrive që mbulojnë fushën e shëndetësisë, mbrojtjes sociale, arsimit, drejtësisë, rendit publik. Këta përfaqësues duhet të mbajnë lidhje informojnë në mënyrë periodike institucionin e tyre dhe institucionet e varësisë.

Licencimet e psikologëve paraqiten të paqëndrueshme

Sipas të dhënave të MSHMS nga ana e Urdhrit të Psikologut prej vitit 2016 janë licensuar gjithsej 1430 psikologë sipas fushave përkatëse, si vijon:

Tabela nr. 7 Licencimet e psikologëve sipas fushave.

Psikologë të licensuar/rilicensuar ne vite	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Gjithsej
Psikologji Edukimi	0	84	35	23	38	18	69	91	27	385
Psikologji për Shëndetin Mendor	0	194	124	43	51	47	117	207	51	834
Psikologji Sociale dhe Komuniteti	0	2	0	0	1	0	0	1	0	4
Psikologji Pune dhe Organizacionale	0	34	22	7	13	10	35	42	14	177
Psikologji Juridike	0	5	2	2	3	2	3	10	3	30
Gjithsej	0	319	183	75	106	77	224	351	95	1430

Burimi: MSHMS, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

²⁵ Urdhri i Ministrisë nr. 414 datë 26.07.2023: Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 313 datë 20.10.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Psiko-social" i ndryshuar;

²⁶ Ligji nr. 90/2014 "Për një shtesë në Ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë";

Në trendin e licencimeve në psikologji edukimi vetëm rreth ¼ e psikologëve janë licencuar në profilin e shkencave të edukimit referuar politikës së re të ndjekur nga MAS në vitin 2023. Ulje e konsiderueshme e numrit të licencimeve paraqitet në vitin 2024, në të cilin janë licencuar në nivel kombëtar vetëm 27 profesionistë. Krahasuar edhe me vitet e mëparshme ky është një numër mjaft i ulët, çka evidenton nevojën për fokus të shtuar nga institucionet përgjegjëse pjesë e këtij urdhri.

Licencimet e punonjësve socialë janë kryer vetëm në dy vitet e fundit

-Urdhri i Punonjës Social aktualisht po në të njëjtën mënyrë, ka të përcaktuar detyrimin për praktikën profesionale për të diplomuarit me “Bachelor” dhe “Master shkencor/ profesional” në punë sociale sipas legjisllacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Sipas të dhënave nga MSHMS për vitet më poshtë nga ana e urdhrit janë licensuar gjithsej 597 punonjës socialë të cilët paraqiten si vijon:

Tabela nr. 8 Licencimet e punonjësve socialë sipas viteve.

Punonjës social të licencuar	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Gjithsej
Pune Sociale	0	0	0	0	0	0	0	518	79	597

Burimi: MSHMS, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

Sa vihet re edhe më sipër, për të paktën 7 vite nga krijimi, nga Urdhri i Punonjës Social nuk është kryer asnjë licencim. Pavarësisht njohjes që ligji dhe VKM-të e nxjerra i kanë bërë punonjësve social të diplomuar, lidhur me njohjen e menjëhershme si anëtar të urdhrit, por dhe hapësirat për ata që kanë punuar në këtë fushë përpara hyrjes në fuqi të ligjit, nuk evidentohet të jenë licencuar e më pas ri-licencuar pas afatit 5 vjeçar. Edhe për punonjës socialë viti 2024 njëlloj si në rastin e licencimeve të psikologëve, paraqitet me një numër të ulët krahasuar me një vit më parë.

Teguesit e mësipërm, mbi prurjet e profesionistëve (diplomimet, licencimet, kërkesat në vend për psikolog), nuk janë bërë pjesë e relacioneve për ndryshimet e bëra gjatë vitit 2023 në Urdhrit nr. 313/2020 për shërbimin psiko-social. Nuk ka një relacion mbështetës mbi prurjet e profesionistëve, numrit të licencimeve në nivel kombëtar, etj. Mosanalizimi i përshtatshëm i treguesve ndikon drejtpërdrejtë në efektivitetin e politikave të ndërmarra dhe rrjedhimisht në drejtim të organizimit dhe funksionimit të shërbimit si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Ka shumë strategji që synojnë të njëjtat çështje, me mjete të ndryshme, por nuk ka asnjë strategji të dedikuar vetëm për shërbimin psiko-social.

Gjatë viteve 2020-2024 kanë qenë në fuqi disa dokumente strategjike që përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë në sistemin arsimor parauniversitar. Strategjitë e hartuara në fusha të ndryshme si, arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, fëmijët dhe rinia etj., trajtojnë brenda tyre në mënyrë të fragmentuar dhe shërbimin psiko-social. Në këto dokumente politikash analizohet situata e këtij shërbimi dhe hartohen objektiva për të ardhmen.

Figura nr. 7 Dokumente strategjike që trajtojnë shërbimin psiko-social.



Punoi: Grupi i Auditimit.

Sipas trajtimeve të bëra në to, shërbimi paraqet problematika thuajse të njëjta/të ngjashme dhe objektivat e parashikuar shpesh herë mbivendosen mes tyre dhe krijojnë paqartësi. Raportet e monitorimit të tyre nuk kanë në të gjitha rastet një vlerësim mbi ecurinë e objektivave për këtë shërbim. Në këto raporte evidentohet se, ka mangësi në raportimin e veprimtarive të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, mungesa të burimeve njerëzore, buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar, të cilat ndikojnë në kryerjen e një analize reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit. Ndërkohë thuajse të gjitha strategjitë evidenton nevojën për një qasje të koordinuar mes institucioneve.

-Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026²⁷ plani i veprimit për zbatimin e saj, vjen fill pas përfundimit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014–2020. Strategjia e re trajton disa problematika për shërbimin psiko-social dhe gjendjen e këtij shërbimi në periudhën e hartimit të saj veç të tjerash, mos ngritjen e shërbimit sipas akteve në fuqi mos mbulimin me specialistë të gjithë institucioneve arsimore etj.

Në të gjatë periudhës së hartimit janë evidentuar nevoja në drejtim të rritjes të vazhdueshëm të numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë dhe shërbimeve që ata ofrojnë në institucionet arsimore. Shërbimi psiko-social pasqyrohet ende i pa konsoliduar, sidomos në nivelin parashkollor dhe se pavarësisht përmirësimeve, infrastruktura shkollore nuk i plotëson standardet e përcaktuara nga shteti. Gjithashtu për shkak të hapësirës së pamjaftueshme shkollore, në zonat urbane ka mbingarkesë të klasave me nxënës.

Disa nga produktet kryesore të synuara për t`u përmbushur nga kjo strategji janë:

Produkti A.2.2 Rritja e cilësisë së shërbimit psiko-social për të gjithë nxënësit

-Shtimi i numrit të punonjësve psiko-social në shkolla.

-Sigurimi i kushteve optimale të punës për shërbimin psiko-social.

-Hartimi dhe standardizimi i protokolleve të punës për shërbimin psiko-social.

²⁷ Miratuar me VKM nr.621 datë 22.10.2021;

-Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social.

-Hartimi i planeve për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve, sidomos në raste pas emergjencave.

Produkti A.2.3 Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të planit të veprimit për shkolla të sigurta.

-Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe minimizimit të gjuhës së urrejtjes në shkolla.

Megjithatë, këto veprime nuk shoqërohen me tregues të matshëm - siç është numri i punonjësve shtesë ose seancat e trajnimit - dhe në vend të kësaj lidhen vetëm me ndarjet e përgjithshme financiare. Monitorimi i strategjisë ndodh çdo gjashtë muaj, por raportet në dispozicion paraqesin kryesisht të dhëna numerike pa një komponent vlerësues. Nuk ka një analizë sistematike se cilat objektiva janë arritur, cilat sfida mbeten ose si duhet të përshtatet drejtimi strategjik në përputhje me rrethanat. Për më tepër, strategjia nuk përfshin detyra të përcaktuara ose ndërveprim me institucione të tilla si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ose Ministri i Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët (MSHRF).

-Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026 është hartuar në vijim të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013-2022. Dokumenti i ri është mbështetur në kuadrin strategjik të fushës së shëndetësisë dhe asaj atë të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si dhe të drejtat e njeriut. Në këtë plan trajtohen shërbimet të shëndetit mendor që mund të ofrojnë forma të ndryshme mbështetjeje (përtej shërbimeve të specializuara) për personat me çrregullime të shëndetit mendor të cilat jepen në institucionet e arsimit parauniversitar si:

-Këshillim nga bashkëmoshatarët (këshilltarët e shkollave)

-Psikologjik;

-Social;

-Mbështetje arsimore për fëmijët me AK.

Qasja socio-shëndetësore dhe ndër sektoriale trajton një përgjigje të koordinuar për shëndetin mendor e cila kërkon integrim më të mirë të ndërhyrjeve shëndetësore me ato sociale, por edhe një partneritet me sektorë të tjerë. Disa nga objektivat specifike të këtij plani janë:

Në objektivin specifik 1.2: Fuqizimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, në masat e parashikuara

1.2.6 Forcimi i sistemit të kujdesit për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe mirëqenies e zhvillimit psiko-social të fëmijëve-adoleshentëve dhe familjeve të tyre, të integruara, të arritshme dhe miqësore më fëmijët, përfshirë shërbimet e specializuara të shëndetit mendor me bazë komunitare, kujdesin shëndetësor parësor, shërbimet psiko-sociale të arsimit parauniversitar, etj.;

1.2.7 Zhvillimi i rrugëve të integruara ndërsektoriale për identifikimin, trajtimin, kujdesin dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë për mbështetje psiko-sociale dhe në shëndet mendor, përfshirë udhëzues për rrugët e referimit, protokolle pune, rregullat e referimit, rolet dhe përgjegjësitë e secilit profesionist, kompetencat, etj.;

1.2.10 Zhvillimi i një pakete trajnimit për profesionistët që ofrojnë kujdes dhe trajtim për fëmijët dhe adoleshentët në nevojë për mbështetje psiko-sociale dhe në aspekte të shëndetit mendor;

1.2.11 Zhvillimi i kapaciteteve për kujdesin e fëmijëve dhe adoleshentëve që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale dhe në aspekte të shëndetit mendor, në një qark të identifikuar paraprakisht nga trajnimit i trajnerëve, mbikëqyrja e mbështetur, trajnimet nëpërmjet trajnerëve të formuar dhe ndjekja në vazhdim.

Këto masa sinjalizojnë një qëllim për të përmirësuar bashkëpunimin ndërsektorial. Megjithatë, mjetet e zbatimit të tilla si mënyra se si është strukturuar koordinimi, kush është përgjegjës për ndjekjen ose si do të shkëmbehen të dhënat midis ministrive -nuk janë përcaktuar qartë.

-Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe plani i saj i veprimit²⁸, vjen pas strategjisë së mëparshme 2020-2023²⁹ e cila në një nga indikatorët referon edhe lidhjen me “Strategjinë për Arsimin”, lidhur me rritjen e numrit të punonjësve psiko-social në shkolla. Pra i referohet shërbimeve psiko-sociale, duke i lidhur objektivat e saj edhe me nevojat në sektorin e arsimit.

Strategjia thekson rëndësinë e monitorimit të rezultateve të arsimit dhe shëndetit dhe sugjeron përmirësimin e bashkëpunimit me urdhrat profesionalë. Megjithatë, ajo nuk përshkruan se si do të zhvillohen proceset ose monitorohet një bashkëpunim i tillë me kalimin e kohës.

-Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026³⁰, në mënyrë të ngjashme përshkruan disa qëllime të lidhura me shërbimet psiko-sociale, të tilla si:

II.2.2.f Hartimi i një politike të dedikuar për arsimin parauniversitar në fushën e parandalimit dhe adresimit të çdo lloj dhune dhe abuzimi, përfshirë bulizimin dhe ekstremizmin në shkolla;

II.2.2.g Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bulizmit dhe ekstremizmit në shkolla;

II.2.2.h Shtimi i numrit të punonjësve psiko-socialë në shkolla;

II.2.2.i Trajnimi i mësuesve dhe punonjësve të njësisë së shërbimit psiko-social dhe komisionet e etikës në shkolla në lidhje me dhunën dhe abuzimin, bulizimin dhe ekstremizmin në shkolla;

II.2.2.ll Fuqizimi i linjave të këshillimit, këshillimit psikologjik dhe shëndetit mendor për fëmijë

Në këtë agjendë trajtohet nevoja hartimin e një politike të dedikuar dhe një qasje gjithëpërfshirëse për të krijuar një sistemi më funksional për identifikimin në kohë, parandalimin dhe raportimin e problematikave tek fëmijët. Në të evidentohet nevoja për një koordinim më të mirë midis shkollave, psikologëve dhe prindërve, dhe thekson harmonizimin e punës me shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve. Megjithatë, pavarësisht njohjes dhe prezantimit të nevojave, sfidave të koordinimit, axhendës i mungojnë mekanizma të detajuar për bashkëpunim ndërsektorial ose monitorim të përgjegjësive të përbashkëta institucionale.

Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe plani i veprimit 2022–2029³¹, është një tjetër dokument politikash objektivat e të cilës lidhen me shërbimin psiko-social janë:

3.2.3 Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkolla me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështeten shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë “Të rinjtë për të rinjtë”.

Pavarësisht se për këtë agjendë MSHRF-ja ka hartuar raporte monitorimi gjashtë mujore evidentohet fakti se, ka mangësi në bashkëveprim dhe raportimin e veprimtarive të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese. Nga ana e saj paraqitet pamjaftueshmëri sa i përket burimeve njerëzore dhe buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar. Faktorë që kanë ndikuar në vlerësimin e saktë të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

²⁸ Miratuar me VKM nr. 152, date 13.03.2024;

²⁹ Miratuar me VKM nr. 866 datë 24.12.2019;

³⁰ Miratuar me VKM nr. 659 datë 03.11.2021;

³¹ VKM nr. 692, datë 26.10.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029”;

Institucionet e arsimit parauniversitar mbledhin të dhëna rreth çështjeve psiko-sociale, por ministrinë nuk i përdorin ato në mënyrë sistematike dhe nuk i ndajnë me njëra-tjetrën.

Të dhënat për shërbimin psiko-social në shkolla raportohen në periudha 3-mujore, dhe vjetore në DPAP dhe më pas ato dërgohen në MAS. Këto të dhëna mbërrijnë në drejtorinë përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Ato përdoren si e dhënë vetëm nga MAS kur nevojiten por nuk dërgohen në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbështetjen sociale apo ministrinë përgjegjëse në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Nga sa vihet re, nuk ka një mekanizëm ndërveprues për treguesit midis MAS dhe MSHMS lidhur me raportimin periodik të treguesve të cilat vilen nga arsimit parauniversitar nga shërbimi psiko-social. Këto të dhëna përbëjnë një bazë mjaft të rëndësishme për vlerësim të situatës së shëndetit mendor të fëmijëve por jo vetëm dhe mund të shfrytëzoheshin më mirë në drejtim të hartimit të politikave më të plota dhe të mbështetura por gjithashtu mund të shërbenin si një masë mjaft efektive për zhvillime në politikat e identifikimit dhe trajtimin e hershëm të tyre. Megjithatë ka një Këshill Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës organ këshillimor me pjesëmarrje edhe nga ministrinë që lidhen me shërbimin psiko-social, nga ky i fundit nuk evidentohet të jenë trajtuar aspekte për shërbimin psiko-social apo të jenë dhënë rekomandime në këtë drejtim.

13- Gjetje nga auditimi: Sistemi i ngritur për shërbimin psiko-social nuk reflekton gjithëpërfshirje dhe qasje ndër sektoriale, për ta bërë atë të qëndrueshëm dhe efektiv, me në qendër fëmijën. Edhe pse strategji të shumta në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale dhe të drejtat e fëmijëve i referohen shërbimeve psiko-sociale, ato e bëjnë këtë në një mënyrë të fragmentuar. Objektivat shpesh mbivendosen, u mungojnë tregues të përbashkët, përgjegjësi të qarta, ose mekanizma për monitorim. Koordinimi midis ministrive është i kufizuar dhe dokumentet ekzistuese strategjike nuk përshkruajnë si duhet të operacionalizohet bashkëpunimi ndërsektorial. Mungesa e ndërveprimit dhe konsultimeve të nevojshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me institucionet e tjera, fushat e përgjegjësisë shtetërore të të cilave lidhen drejtpërdrejt me shërbimin psiko-social, e ka lënë atë të vetme në përballimin e sfidave që ky shërbim relativisht i ri ka në dinamikën e vet. Kjo ka ndikuar negativisht në sigurimin e planifikimit dhe ofrimit të përshtatshëm të shërbimeve psiko-sociale.

14- Gjetje nga auditimi: Kuadri rregullator në fuqi për shërbimin psiko-social nuk garanton qëndrueshmëri strukturore, bashkëveprim mes institucioneve, transparencë dhe mundësi të barabarta në rekrutimin e profesionistëve, si dhe bie ndesh me përcaktime në akte të tjera ligjore. Përkatësisht, Urdhri i Ministrit nr. 313, datë 20.10.2020: “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Psiko-social” i ndryshuar, i cili është akti bazë rregullator për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë viteve objekt auditimi. Këto ndryshime nuk janë bazuar në analiza të thelluara të situatës dhe gjendjes së shërbimit në vend. Një prej ndryshimeve të rëndësishme të këtij urdhri është kriteri i vendosur gjatë vitit 2023, për rekrutimin e psikologëve të fushës “psikologji edukimi”, i cili ka përjashtuar fushat e tjera të psikologjisë. Ky ndryshim është miratuar në mungesë të një analize të plotë dhe gjithëpërfshirëse të burimeve profesionale në vend, duke krijuar kufizime të panevojshme për këtë kategori specialistësh. Mënyra aktuale e organizimit dhe funksionimit të shërbimit psiko-social me urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin, nuk mundëson një kornizë rregullatore bashkëveprimi me institucionet e tjera përgjegjëse, duke qenë se, shërbimi psiko-social në arsimin parauniversitar ndërthur disa fusha veprimtarie shtetërore që mbulohen nga ministri të ndryshme. Kjo mënyrë funksionimi e ekspozon shërbimin psiko-social ndaj ndryshimeve strukturore të njëanshme dhe nuk mundëson qasje bashkëvepruese ndër-institucionale në drejtim të rritjes së cilësisë së tij. Ndërkohë, Urdhri nr.

313 evidenton edhe problematika të tjera, pasi në të nuk përcaktohet mënyra si kryhet përzgjedhja mes dy figurave profesionale psikolog dhe/ose punonjës social; nuk përcaktohet konkurrim për supervisorët e psikologëve/punonjësve socialë, si dhe kohëzgjatja e tyre në detyrë; nuk vendosen kufizime lidhur me ushtrimin e detyrës së psikologut dhe supervisorit në juridiksionin ku ata supervizojnë, duke krijuar bazë për konflikt interesi. Dispozitat e urdhrin bien ndesh me përcaktimet e Kodit të Punës sa i përket zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. Nga ana tjetër, Rregullorja e Brendshme për funksionimin e IAP-ve gjendet e papërditësuar me ndryshimet që kanë ndodhur prej Tetorit 2020 në shërbimin psiko – social, duke krijuar paqartësi në zbatim.

15- Gjetje nga auditimi: Të dhënat e raportuara nga shërbimi psiko-social nuk ndahen rregullisht me ministritë e tjera. Njësitë e shërbimit psiko-social raportojnë periodikisht të dhëna mbi shërbimin psiko-social në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar e cila, pasi i konsolidon ato, i dërgon më pas në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit çdo 6-muaj. Ato nuk përcillen më tej në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo Ministrin e Shtetit për fëmijët dhe Rininë, për vlerësim apo prodhim politikash sipas fushave të përgjegjësisë. Këto të fundit, marrin informacione pjesore vetëm mbi bazë kërkesë në MAS, në rastet kur nevojiten të dhëna për strategjitë që secila prej tyre ndjek brenda fushës së veprimtarisë. Të dhënat janë numerike dhe pasqyrojnë rezultatet e veprimtarisë së psikologëve dhe punonjësve socialë me nxënësit në rang kombëtar. Në to paraqiten të dhëna të rëndësishme mbi problematikat në shkolla fenomenet dominuese etj. Si rezultat, sistemi i mungon një bazë e përbashkët provash për të mbështetur hartimin e politikave ndërministrorë dhe për të monitoruar efektivitetin e shërbimeve me kalimin e kohës.

3. Konkluzioni: Politikat dhe veprimtaritë e ndërmarra nga ana e institucioneve kanë qenë të fragmentuara dhe nuk kanë arritur të jenë plotësisht në mbështetje të shërbimit psiko-social. Sistemi i ngritur nuk gjendet i mbështetur në baza të qëndrueshme sa i përket kuadrit ligjor rregullator mbi të cilat ai është ndërtuar dhe funksionon. Ai paraqitet lehtësisht i ndryshueshëm në vijueshmërinë e tij. Bashkëveprimi i munguar mes institucioneve në shkëmbimin e informacioneve lidhur me fenomenet që iu përkasin fushave të tyre të përgjegjësisë, ndikon në efektivitetin e politikave të ndërmarra dhe për rrjedhojë edhe në garantimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

13.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit³², të vlerësojnë hartimin e një strategjie të veçantë për shërbimin psiko-social në arsimin parauniversitar. Kjo, bazuar në analizën e problematikave aktuale dhe kapacitetet njerëzore të profesionistëve në vend, duke evidentuar gjithashtu në mënyrë të qartë rolet dhe detyrat e institucioneve sipas fushës së përgjegjësisë.

Brenda datës 30.06.2026

13-14.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të ndërmarrin hapat e nevojshëm, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në një formë të re ligjore/rregullatore, e cila të garantojë qëndrueshmërinë e shërbimit nga ana strukturore, kornizën e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndër-institucional, eliminimin e barrierave të panevojshme në rekrutimin e specialistëve, transparencë dhe ecuri në karrierë për specialistët e shërbimit psiko-social, si dhe përputhmërinë me aktet e tjera ligjore në fuqi.

Brenda datës 30.06.2026

³² Ministria përgjegjëse për rininë sipas fushës së përgjegjësive shtetërore të VKM-së nr. 512, datë 25.9.2025;

15.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë periodikisht informacione që lidhen me fushën psiko-sociale në arsimin parauniversitar, me qëllim garantimin e politikave sa më të qarta dhe të mbështetura me në qendër fëmijët.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. OBSERVACIONE TË SUBJEKTEVE NËN AUDITIM

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr.3802/1 prot, datë 24.10.2025 regjistruar në KLSH me nr. 629/8 prot datë 28.10.2025, ka paraqitur komente mbi Projektraportin të cilat në mënyrë të përmbledhur i paraqesim si vijon.

MSHMS shpreh gatishmërinë për të kontribuar brenda kompetencave të veta në zbatimin e rekomandimeve për shërbimin psiko-social në shkolla. Në komente ajo trajton se, roli i saj mund të jetë kontributiv në hartimin e strategjisë specifike për shërbimin psiko-social, rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator, shkëmbimin e çdo informacion që mund të kërkohet nga MAS.

Gjithashtu trajtohet se, në paragrafin në faqe 49 të Projektraportit, në kuadër të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2020-2023 përmendet në një paragraf, përfshirja e një indikatorit për rritjen e punonjësve psiko-socialë të parashikuar në shkolla, i cili thuhet është parashikuar në “Strategjinë për Arsimin 2021-2026”. Në fakt, ky indikator lidhej kryesisht me shtimin e mësuesve ndihmës për fëmijët me AK dhe jo me zgjerimin e shërbimit psiko-social. Për këtë sugjerohet të saktësohet roli i indikatorit dhe lidhja e tij me masat e strategjisë për mbrojtjen sociale e cila nuk ka pasur objektiva në fushën e arsimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Në Strategjinë për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 gjendet *Indikatorit nr. 12* :“*Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë (shërbimi psiko-social) në arsimin publik parauniversitar-Strategjia e Arsimit Parauniversitar*”. Indikatorit i referohet Strategjisë për Arsimin dhe paraqet traqetin për tu përmbushur sipas viteve, numri i psikologëve dhe punonjësve socialë të punësuar në sistemin publik parauniversitar/sipas bashkive me objektiv rritje 10% në vitin 2020, 20% në vitin 2021, si dhe vijon me vlerat për vitet në vijim. Në strategjinë 2020-2023, por atë pasuese trajtohet ngritja dhe më tej forcimi i rolit të urdhrin të punonjësve social, bashkëpunimi me urdhrin e psikologut. Theksojmë se, Urdhri nr. 313/2020 për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social parashikon profesionistë shtesë mbi një numër të caktuar nxënësish me AK në shkolla. Gjithashtu, MSHMS është institucioni kryesor për krijimin e 2 urdhrave profesionalë pasi mbulon dy fushat përkatëse shëndetësi dhe mbrojtje/mirëqenie sociale. Pra roli dhe ndërveprimi është evident. Paraqitja e indikatorit dhe objektivave në këtë rast është trajtuar në kontekstin e përfshirjes së shërbimit psiko-social në dokumentet strategjike. Sa më sipër, nuk vlerësohet të kryhen ndryshime në material.

Ministria e Arsimit me shkresën nr.321/2 prot, datë 31.10.2025 regjistruar në KLSH me nr. 629/9 prot datë 05.11.2025, ka paraqitur komente mbi disa nga rekomandimet të Projektraportit të dërguar, të cilat në mënyrë të përmbledhur i paraqesim si vijon:

Për rekomandimin nr. 1.1; nr.3.1, nr.5.1 dhe nr.13.1 trajtohet se, pas ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2025 në Urdhrin nr. 313 të vitit 2020, po kryhen ri-organizimet dhe në fund të këtij procesi do të bëhen analizat.

Për rekomandimin nr. 6.1 trajtohet se, procesi i supervizimit funksionon dhe është i rregulluar në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social. ASCAP gjatë punës së saj ka bërë përpjekje bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Sociale dhe ka pasur edhe bashkëpunim si në rastin e pyetjeve të konkursit për rekrutimin e punonjësve të shërbimit psiko-social.

Për rekomandimin nr. 7.1 trajtohet se, gjatë vitit shkollor janë zhvilluar veprimtari informuese dhe sensibilizuese me gjithë aktorët në shkollë me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit tek nxënësit.

Për rekomandimin nr. 8.1 trajtohet se, punonjësit e shërbimit psiko-social referuar planeve të veprimit e strategjive ndërsektoriale bëjnë planifikime vjetore duke marrë në konsideratë specifikat e zonës ku gjendet shkolla apo karakteristikat e komunitetit.

Për rekomandimin nr. 9.1 trajtohet se, ASCAP ka hartuar draft-dokumentin për parandalimin e raportimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar. Dokumenti është dërguar për mendime tek grupi i punës dhe palë të interesuara. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë përditësuar dokumenti për etikën profesionale të shërbimit psiko-social dhe Udhëzuesi për praktikën e punës.

Për rekomandimin nr. 10.1 trajtohet se, ASCAP nuk ka një sistem vlerësimi të performancës së shërbimit psiko-social dhe do të planifikojë metodologji për vlerësimin e tij.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Observacionet e paraqitura nga Ministria e Arsimit paraqesin në mënyrë të përgjithshme disa hapa që janë ndërmarrë prej saj dhe institucioneve në varësi të saj. Lidhur me disa komente mbi veprimtari të zhvilluara me fakultetet, ndërgjegjësimin, supervizimin, theksojmë se ato kanë qenë pjesë e shqyrtimit gjatë procesit auditues. Duke qenë se auditimi përfshin periudhën 01.01.2020-30.04.2024, disa nga veprimet administrative të ndërmarra kryesisht gjatë vitit 2025, përbëjnë një hap pozitiv, por ato gjenden jashtë periudhës së auditimit, e si të tilla ato do të jenë objekt vlerësimi gjatë auditimit që KLSH do të zhvillojë në vijim për të monitoruar përmbushjen e rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse. Sa më sipër, nuk vlerësohet të kryhen ndryshime në material.

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT